




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

---

# MBROJTJA, ZHVILLIMI DHE RIPËRTËRITJA E HAPËSIRAVE PYJORE

Prishtinë, gusht 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji<sup>1</sup> i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit, që kryesohet nga Auditori i Përgjithshëm, e ndihmon në kryerjen e detyrave të tij/saj. Së bashku kontribuojnë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve.

Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 300012).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë<sup>3</sup>, efikasitetit<sup>4</sup> dhe efektivitetit<sup>5</sup> dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Mbrotjtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore” në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i departamentit të auditimit

Agron Hoxha, Udhëheqës i ekipit;

Verona Sekiraqa, Anëtare e ekipit;

---

1 Ligji 05/L\_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

2 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

3 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

4 Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

5 Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

## Tabela e përmbajtjes

|                                                                                                   |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje e përgjithshme .....                                                                  | 4  |
| 1 Hyrje.....                                                                                      | 7  |
| 2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet .....                                                         | 9  |
| 3 Gjetjet e auditimit.....                                                                        | 10 |
| 3.1.1 Mungesa e bazës rregullative për funksionet kyçe të Agjencisë Pyjore .....                  | 10 |
| 3.1.2 Mos arritja e objektivave të Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë .....                  | 11 |
| 3.1.3 Mungesa efikasitetit të Inspektoratit të MBPZHR-së në mbrojtjen e pyjeve .....              | 12 |
| 3.2 Mungesa e masave për mbrojtjen e pyjeve publike .....                                         | 15 |
| 3.2.1 Menaxhimi jo efektiv i Parqeve Kombëtare .....                                              | 18 |
| Parku kombëtar Bjeshkët e Nemuna.....                                                             | 18 |
| Parku Kombëtar Sharri .....                                                                       | 19 |
| Mungesa e trajtimit të sëmundjeve të shfaqura në pyjet e parqeve kombëtare .....                  | 20 |
| 3.2.2 Uzurpimi i pronave të cilat i menaxhon Agjencia Pyjore .....                                | 21 |
| 3.2.3 Agjencia Pyjore nuk ka informacione të plota për pronat të cilat i menaxhon.....            | 22 |
| 3.2.4 Ndryshimet kadastrale të pronave të menaxhuara nga Agjencia Pyjore .....                    | 23 |
| 3.3 Mungesa e inventarizimit të pyjeve në vend .....                                              | 25 |
| 3.3.1 Mungesa e Planeve Menaxhuese 10 vjeçare të Pyjeve.....                                      | 25 |
| 3.3.2 Mos arritja e objektivave të planeve vjetore.....                                           | 26 |
| 3.3.3 Mangësi në procesin e dhënies së pronave me qira.....                                       | 28 |
| 3.3.4 Mungesa e mbikëqyrjes së kontratave të qiradhënies .....                                    | 31 |
| 3.3.5 Mungesa e ri-kultivimit të zonave pas shfrytëzimit .....                                    | 32 |
| 4 Konkluzionet.....                                                                               | 35 |
| 5 Rekomandimet .....                                                                              | 36 |
| Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia ..... | 37 |
| Shtojca 2: Letër konfirmimet .....                                                                | 44 |

## **Lista e Shkurtesave**

**AKK** – Agjencia Kadastrale e Kosovës

**AKP** – Agjencia Kosovare e Privatizimit

**AMMK** – Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

**APK** – Agjencia Pyjore e Kosovës

**AUVK** – Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës e Kosovës

**BE** – Bashkimi Evropian

**DKR** – Drejtoria Koordinuese Regjionale APK

**IKMN** – Instituti Kombëtar për Mbrojtjen të Natyrës

**KEDS** – Kompania Kosovare për Distribim të Energjisë Elektrike në Kosovë sh.a

**KEK** – Korporata energjetike e Kosovës

**KPMM** – Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

**MBPZHR** – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**MMPHI** – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

**NFG** – Norwegian Forest Group

**SBZHR** – Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028

**ZKA** – Zyra Kombëtare e Auditimit

**SZHP** -Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë

## Përmbledhje e përgjithshme

Pyjet në Kosovë përbëjnë një pasuri natyrore me rëndësi të veçantë për biodiversitetin, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Këto pyje janë të shpërndara si brenda zonave të mbrojtura, përfshirë Parkun Kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, ashtu edhe jashtë tyre, sipërfaqe që janë në pronësi publike dhe private. Megjithatë, menaxhimi i qëndrueshëm i tyre vazhdon të jetë sfidues, për shkak të dukurive të vazhdueshme si prerjet e paligjshme të drunjve, zjarret pyjore, shfrytëzimi i paligjshëm i resurseve dhe ndërtimet pa leje në zona të mbrojtura.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën ***Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore***. Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësohej efikasiteti i institucioneve përgjegjëse në mbrojtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e hapësirave pyjore.

Auditimi ka mbuluar periudhën 2020–2024 për procesin e qiradhënies së hapësirave pyjore dhe nivelin e arritjes së planeve menaxhuese, ndërsa për analizimin e ndryshimeve kadastrale janë trajtuar të dhëna që nga viti 2014.

Hapësirat pyjore ishin ndër pasuritë publike më të atakuara dhe dëmtuara pas luftës ndërsa sipas zyrtarëve të Agjencisë Pyjore, vitet e fundit ky trend është në rënie. Rezultatet e auditimit tregojnë se ende ka sfida serioze. Mungesa e kornizës së qartë ligjore/rregullative, kontrollit efektiv dhe koordinimit institucional ka lejuar prerje ilegale, uzurpime dhe dëmtime në zonat e mbrojtura, duke sjellë humbje të mëdha ekonomike dhe mjedisore.

Institucionet përgjegjëse si: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, nuk kanë arritur të menaxhojnë në mënyrë të duhur hapësirat pyjore të vendit. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka arritur të përgatisë dhe të miratojë udhëzimet administrative të nevojshme për menaxhimin e pyjeve. Si rezultat, Agjencia Pyjore e Kosovës operon pa kornizë të plotë rregullative për disa nga funksionet e saj thelbësore, përfshirë: inventarizimin e pyjeve, hartimin e planeve për rikultivim, si dhe procesin e dhënies me qira të hapësirave dhe resurseve pyjore.

***Mungesa e Mbikëqyrjes së Pyjeve Publike.*** Agjencia Pyjore e Kosovës nuk ka arritur të organizojë në mënyrë efektive mbrojtjen e pyjeve publike, duke përfshirë mbikëqyrjen dhe regjistrimin e sipërfaqeve pyjore. Vitet e fundit vërehet progres lidhur me regjistrimet në terren për gjendjen e pyjeve, megjithatë raportet shpesh nuk pasqyrojnë gjendjen faktike për shkak të raportimeve jo të plota dhe mungesës së mbikëqyrjes së rregullt në terrenet pyjore. Në mungesë të mbikëqyrjes dhe kontroleve të duhura në teren, ka dëmtime të masës drusore në vend si dhe humbje të konsiderueshme nga zjarret.

***Mungesa e kontrollit efektiv nga inspektorati si mekanizëm kyç ka ndikuar në keqpërdorime të pyjeve dhe dëmtim të pronës publike.*** Deri në vitin 2023, Inspektorati i Pyjeve ka funksionuar brenda strukturës së Agjencisë Pyjore, ndërsa nga viti 2023 operon në MBPZHR. Operimi nën Agjencinë Pyjore për një periudhë të gjatë ka ndikuar negativisht në pavarësinë dhe objektivitetin e veprimtarive të tij inspektuese. Mungesa e inspektimeve efektive ka krijuar hapësirë për veprime të paligjshme nga operatorë ekonomikë, duke rezultuar në dëmtim të pyjeve dhe abuzim me pronën publike.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është në proces të riorganizimit/themelimit të inspektorateve qendrore, mirëpo ende nuk ka krijuar bazë ligjore/rregullative për funksionimin e inspektoratit të pyjeve si dhe nuk ka arritur të ushtroj mbikëqyrje dhe monitorim efektiv mbi punën e inspektoratit të pyjeve, gjë që ka ndikuar në mos reagim institucional ndaj dëmtimeve në hapësirat pyjore.



Ndikimi i inspektoratit në ruajtjen e hapësirave pyjore ishte treguar kyç në disa raste duke evidentuar dhe ndërmarrë masa konkrete ndaj shkeljeve për shfrytëzim të pronës pyjore nga operator të ndryshëm për vite me radhë pa kontratë apo duke kërkuar formimin e komisioneve të dyta për regjistrim të jashtëzakonshëm të pyjeve apo monitorim të terreneve pyjore, për pasqyrim të saktë të gjendjes në terren.

***Parqet Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri" vazhdojnë të përballen me sfida serioze, përfshirë prerjet ilegale dhe ndërtime pa leje,*** të cilat kanë shkaktuar përkeqësim të gjendjes brenda zonave të mbrojtura. Sipas Drejtorisë së Parkut Kombëtar "Sharri", rreth 70% e territorit nuk mbulohet me roje pyjore, çka ka ndikuar në shkallë të lartë të prerjeve të paligjshme. Ndërsa, në Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" numri i ndërtimeve pa leje është dyfishuar – për periudhën 2010 deri 2024, nga rreth 2,900 në vitin 2010 në mbi 6,000 në regjistrimet e fundit të vitit 2024.

Në bazë të vlerësimit të Institutit Pyjor të Kosovës rreth 3% e sipërfaqes pyjore brenda këtyre parqeve është e prekur nga sëmundje dhe dëmtues të pyjeve, të cilat nuk po trajtohen për shkak të mungesës së koordinimit ndërinstitucional dhe mungesës së masave të duhura të reagimit.

***Mungesa e unifikimit të emërtimeve të pronave dhe ndryshimet kadastrale pa dijeni të Agjencisë tregojnë dobësi serioze në kontrollin e pronave pyjore publike.*** Agjencia Pyjore e Kosovës nuk posedon të dhëna të sakta dhe të plota lidhur me numrin e uzurpimeve të pronave publike. Deri në vitin 2024, ishin të identifikuar 246 raste të uzurpimit, ndërkohë që pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pyje<sup>6</sup> janë paraqitur 2,242 aplikime për qiradhënie nga shfrytëzues të pronave publike. Kjo mospërputhje tregon për shfrytëzim të gjerë të paautorizuar të pronave publike për vite me radhë.

Për më tepër, mbi 20 vite Agjencia Pyjore nuk ka trajtuar çështjen e pronave nën menaxhimin e saj. Agjencia menaxhon prona me rreth 500 emërtime të ndryshme, për të cilat ende nuk ka kryer unifikimin dhe verifikimin e tyre. Si rezultat, Agjencia Pyjore nuk ka informacion të saktë dhe të përditësuar për pronat që menaxhon. Gjithashtu, nga të dhënat kadastrale rreth 11,600 hektarë të sipërfaqeve pyjore kanë pësuar ndryshime kadastrale gjatë periudhës 2014-2024. Disa nga këto ndryshime lidhen me procesin e privatizimit, vendime nga qeveria dhe komunat, për ndërrim të pronësisë, si dhe me vendime gjyqësore, çka tregon për mungesë të theksuar të koordinimit ndërinstitucional dhe kontrollit pronësor. Viteve të fundit kishte iniciativë të unifikimit të emërtimeve të pronave, megjithatë sipas Agjencisë Pyjore paqartësitë ligjore janë shfaqur si pengesë.

***Mungesa e inventarizimit të pyjeve.*** Agjencia Pyjore e Kosovës nuk ka realizuar një inventarizim të plotë dhe të përditësuar të pyjeve, gjë që ka rezultuar në mungesë të të dhënave të sakta për gjendjen aktuale të resurseve pyjore. Kjo ka penguar planifikimin efektiv dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të pyjeve. Nga 76 njësi menaxhuese<sup>7</sup> ekzistuese, 25 nuk kanë plane menaxhuese afatgjata (10-vjeçare), duke kufizuar aftësinë institucionale për të ndërmarrë masa të mirëfillta të zhvillimit pyjor.

***Realizimi i pamjaftueshëm i objektivave dhe rrezikimi i fidanishteve.*** Agjencia Pyjore e Kosovës nuk ka arritur të realizojë rreth 44% të objektivave të planifikuara në planet vjetore.

<sup>6</sup> Ligji nr.08/l-137 për Pyje, 2023

<sup>7</sup> Njësia menaxhuese pyjore - është ndarje hapësinore për planifikimin e menaxhimit të pyjeve e ndarë në ngastra dhe nën ngastra pyjore.

Ngecjet janë më të theksuara në kultivimin, trajtimin dhe ngritjen e pyjeve të reja. Rreth një milion fidanë që ndodhen në fidanishten e Institutit Pyjor të Kosovës rrezikojnë të dështojnë për shkak të mungesës së kontraktimeve për pyllëzim nga ana e Agjencisë.

***Probleme në procesin e qiradhënies dhe mbikëqyrjes së kontratave.*** Procesi i qiradhënies së pronave publike nga Agjencia Pyjore e Kosovës është karakterizuar me vonesa të konsiderueshme dhe mungesë transparence institucionale. Në disa raste, trajtimi i kërkesave për qiradhënie ka zgjatur deri në 38 muaj, duke krijuar pasiguri për qiramarrësit dhe duke ndikuar negativisht në zhvillimin e aktiviteteve të tyre afariste.

Përveç kësaj, Agjencia nuk ka zhvilluar një sistem të rregullt dhe funksional për monitorimin e zbatimit të kontratave të qiradhënies. Si pasojë, janë evidentuar një sërë shkeljesh nga ana e qiramarrësve, përfshirë: përdorimin e pronës jashtë destinimit të kontraktuar, tejkalimin e afateve të përcaktuara kohore.

Për eliminimin e këtyre parregullsive krerët e institucioneve përgjegjëse duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme me qëllim të menaxhimit adekuat të hapësirave pyjore të Kosovës. Një koordinim ndërinstitutional po ashtu është i nevojshëm me qëllim të ruajtjes, zhvillimit dhe ripërtëritjes së hapësirave pyjore të vendit. Për këtë kemi dhënë 11 rekomandime të cilat gjenden në kapitullin 5 të këtij raporti.

#### **Përgjigja e entiteteve të përfshira në auditim**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencioni Pyjor i Kosovës dhe Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna. Ndërsa, nuk kemi pranuar përgjigje nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Inkurajojmë subjektet e përfshira në këtë auditim që ti bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

## 1 Hyrje

Hapësirat pyjore në Kosovë kanë shtrirje në një sipërfaqe rreth 481,000 ha ose 44.7% e sipërfaqes totale në vend, prej tyre 38% e sipërfaqes pyjore është në pronësi private, ndërsa 62% janë pyje publike, në një sipërfaqe prej 295,200ha.

Pyjet më cilësore shtrihen në parqe kombëtare të “Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna” të cilat kanë një sipërfaqe prej 125,000 ha të cilat janë nën menaxhimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI-së), ku aktiviteti brenda pyjeve në parqet kombëtare është i rregulluar me ligje të veçanta.

Pyjet janë një nga pasuritë kryesore natyrore të vendit tonë. Ato kanë rol jetik në zbutjen e ndryshimeve klimatike, të tilla si nxehtësia ekstreme, thatësira dhe përmbytjet, janë prodhues i madh i oksigjenit dhe pastrimit të ajrit, duke bërë thithjen e gazrave ndotëse, si dioksidi i karbonit dhe ruajnë atë në biomasën e tij për të parandaluar hyrjen e tij në atmosferë.

Menaxhimi i pyjeve është objektiva e 15 “Jeta në Tokë” e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-Sustainable Development Goals) të vendosura nga Kombet e Bashkuara (OKB), në vitin 2015 të cilat duhet të arrihen deri në vitin 2030. Kjo objektivë synon të mbrojë, rivendosë dhe promovojë përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, të menaxhojë në mënyrë të qëndrueshme pyjet, të ndalojë degradimin e tokës dhe humbjen e biodiversitetit.

Pyjet kanë ndikim të rëndësishëm në pengimin e degradimit të tokës, rrënjët e pemëve forcojnë tokën dhe kontrollojnë erozionin e tokës, duke minimizuar kështu efektet e stuhive dhe përmbytjeve. Drurët arrijnë të ulin temperaturat deri 12°C, si dhe të ruajnë ujin. Sistemet rrënjësore shërbejnë si zona ujëmbledhëse që nxisin infiltrimin, kjo parandalon që uji i reshjeve të sjellë ndotje në burimet tona ujore si lumenj apo liqene.

Pyjet krijojnë mundësi ekonomike, përveç përdorimit të frutave të ndryshëm, gjethet, lëvoret, bisqet, rrënjët ofrojnë dhe mundësinë për përpunimin e tyre duke nxjerrë nën-produkte e duke ofruar gjithnjë e më shumë të ardhura, përveç frutave për njerëzit, pemët ofrojnë ushqim por edhe vend strehim për zogjtë dhe kafshët e egra.

Pyjet dhe hapësirat pyjore shtetërore menaxhohen nga Agjencia Pyjore e Kosovës (tutje Agjencia Pyjore), si agjenci e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje MBPZHR), ndërsa menaxhimi i pyjeve brenda parqeve kombëtare bëhet nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (tutje AMMK) e cila vepron në kuadër të MMPHI-së. Për nevoja të planifikimit strategjik dhe hartimit të politikave për shfrytëzim të qëndrueshëm të pyjeve në vend, Agjencia Pyjore bënë inventarizimin e pyjeve çdo 10 vite. Inventarizimi i pyjeve për herë të parë është bërë në vitin 2002, pastaj inventarizimi i dytë është bërë në vitin 2012.


Në bazë të inventarizimit të fundit në vitin 2012 gjendja e pyjeve në Kosovë dhe klasave të përdorimit të tokës janë si në vijim:



Tabela 1: Zhvillimi i sipërfaqes totale sipas klasave të përdorimit të tokës të vitit 2012.<sup>8</sup>

| Klasat e përdorimit të tokës | Ha               | %          |
|------------------------------|------------------|------------|
| Pyje                         | 481,000          | 44.7       |
| Tokë tjetër pyjore           | 29,200           | 2.7        |
| Tokë bujqësore               | 309,000          | 28.7       |
| Livadhe/kullosa              | 161,400          | 15.0       |
| Vendbanime                   | 48,000           | 4.5        |
| Ujë                          | 5,200            | 0.5        |
| Tokë tjetër e lagësht        | 800              | 0.1        |
| Tokë tjetër                  | 42,400           | 3.9        |
| Jo-klasifikuar               | 0                | 0.0        |
| <b>Totali</b>                | <b>1,077,000</b> | <b>100</b> |

Grafiku 1. Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës)



Pyjet në vendin tonë pjesën më të madhe janë të llojit fletorë<sup>9</sup>. Llojet dominuese të fletoreve të fortë janë: Dushqet, Ahu, Frashëri, Shkoza, ndërsa fletorë të butë janë: Mështekna, Panja, Bliri, Verri etj. Në pyjet halore dominojnë llojet: Bredhi, Hormoqi, llojet e Pishës etj.

Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore ka ndikim në ekonominë kombëtare duke ruajtur ekuilibrin ndërmjet funksioneve ekonomike, ekologjike dhe shoqërore të pyjeve.

Koncepti i menaxhimit të qëndrueshëm dhe të integruar të pyjeve, konsiston ndër të tjera në përcaktimin e balancit në mes të shfrytëzimit ekonomik të pyjeve krahas kapaciteteve regjeneruese, përkatësisht përdorimit, shfrytëzimit dhe menaxhimit të tyre sot, konform nevojës për ruajtjen e potencialit të tyre për të ardhmen.<sup>10</sup>

<sup>8</sup> Inventarizimi Nacional i Pyjeve Kosovë 2012, Agjencia Pyjor e Kosovës, Prishtinë, 2013

<sup>9</sup> Gjetherënësë

<sup>10</sup> Plani vjetor i menaxhimit të pyjeve, faqe 3, 2024

## 2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet

Objektivë e këtij auditimi është të vlerësohet efikasiteti i institucioneve përgjegjëse në mbrojtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e hapësirave pyjore.

Ky auditim adreson rezultatin dhe efikasitetin e institucioneve përgjegjëse si dhe ofron rekomandime për mbrojtjen e pyjeve, zhvillimin si dhe për realizimin e proceseve transparente të shfrytëzimit të hapësirave pyjore.

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, kemi përdorur pyetjet në vijim:

1. *Sa kanë arritur Agjencia Pyjore e Kosovës dhe AMMK të bëjnë zhvillimin dhe mbrojtjen hapësirave pyjore?*
2. *Si janë menaxhuar aktivitetet dhe proceset për shfrytëzim të lëndëve drusore dhe hapësirave pyjore?*

Fushëveprim i këtij auditimi është në MBPZHR, përkatësisht Departamenti i Pylltarisë, i cili bënë hartimin e politikave në fushën e pylltarisë, ndërsa përmes Departamentit Qendror të Inspektoratit për Pylltari dhe Gjueti, MBPZHR-ja do të sigurohet për zbatimin e ligjit për pyje.

Auditimi është fokusuar me theks të veçantë në aktivitetin e Agjencisë Pyjore, e cila vepron në kuadër të MBPZHR-së. Fushëveprim i këtij auditimi është edhe AMMK-ja, përkatësisht Drejtoria Parku kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Drejtoria Parku Kombëtar "Sharri".

Ndërsa në Agjencinë Kadastrale të Kosovës kemi siguruar të dhënat kadastrale të pronave pyjore shtetërore me të gjithë emrat me të cilat ato janë të regjistruara. Për analizimin e proceseve të qiradhënies së hapësirave pyjore, nivelit të arritjes së planeve menaxhuese, periudha e auditimit ka përfshirë vitet 2020-2024, ndërsa për analizimin e ndryshimeve kadastrale kemi përdorur të dhëna nga viti 2014.

Metodologjia e detajuar e aplikuar gjatë këtij auditimi, nën-pyetjet, kriteret dhe fushëveprimi i detajuar i auditimit janë paraqitur në Shtojcë.

### 3 Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet të cilat janë si rrjedhojë e mos ndërmarrjes së veprimeve të duhura të institucioneve përgjegjëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve në vend.

Si rezultat i mos menaxhimit të mirë, hapësirat pyjore vazhdojnë të degradohen dhe të shfrytëzohen në mënyrë të paautorizuar, përfshirë ndërtimet ilegale dhe dëmtimin e pronave shtetërore që janë nën menaxhimin e Agjencisë Pyjore.

Gjetjet kanë të bëjnë me: mos hartimin e rregulloreve dhe udhëzuesve për menaxhimin me pyje, mungesën e inventarizimit të pyjeve, mungesa e transparencës dhe e monitorimit të qiradhënies, të dhëna jo të sakta të regjistrimeve të terreneve pyjore, mungesa e evidentimit të uzurpimeve, trajtimi jo i duhur i pyjeve në Parqet Kombëtare, mos inspektimeve dhe i mostrajtitimit të rasteve të sinjalizimit etj.

Këto dhe gjetjet tjera të paraqitura në vijim tregojnë se pyjet në vend nuk janë menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme, duke rezultuar në dëmtimin e tyre, për të cilin nevojiten dekada që të rikthehen në gjendje cilësore.

#### 3.1.1 Mungesa e bazës rregullative për funksionet kyçe të Agjencisë Pyjore

*Zbatimi i politikave për pyjet në vend duhet të sigurohet nga departamenti i pylltarisë në MBPZHR i cili ndër të tjera ka këto kompetenca: Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive në fushën e pylltarisë, bënë inventarizimin e përgjithshëm të pyjeve, kafshëve të egra, dhe organizimin, përpunimin, mbajtjen e statistikave pyjore.<sup>11</sup>*

Agjencia Pyjore nga viti 2003 ka funksionuar në bazë të Ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës dhe kishte të miratuar Udhëzuesit Administrativ (tutje UA) për menaxhimin e pyjeve. Me qëllim të krijimit të bazës ligjore më të avancuar në menaxhimin e pyjeve dhe harmonizimit me Direktivat e BE-së në vitin 2023 është miratuar ligji i ri për pyjet<sup>12</sup>. Ky ligj parashihte miratimin e akteve nënligjore brenda gjashtë muajve. Megjithatë, deri në pjesën e parë të vitit 2025 janë miratuar katër UA dhe sipas Ministrisë, gjashtë UA kanë përfunduar të gjithë hapat procedural dhe janë në pritje të miratimit nga Ministri, ndërkohë, për tre UA ende nuk ka filluar procesi i hartimit. Andaj ligji i ri për pyjet ende nuk është përcjellur me miratimin e UA të nevojshme për menaxhimin e hapësirave pyjore.

Përderisa, UA i cili rregullon procedurat e qiradhënies nuk është miratuar për shkak të pengesave të cilat janë paraqitur me Ligjin për Pronën Publike.

Si pasojë, Agjencia Pyjore e Kosovës vazhdon të funksionojë pa UA për fusha thelbësore, të cilat janë të domosdoshme për rregullimin e proceseve kyçe si: inventarizimi kombëtar i pyjeve, proceset për ri-kultivimin e pyjeve, për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe procese tjera.

<sup>11</sup> Rregullore (QRK) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MBPZHR

<sup>12</sup> Ligji nr.08/l-137 për pyjet

Mungesa e udhëzimeve administrative krijon boshllëqe në zbatimin e ligjit për pyjet, si procesi i ri-kultivimit të pyjeve, mbrojtjes së tyre e çështje tjera duke penguar standardizimin e proceseve kyçe dhe rritur pasigurinë juridike. Kjo dobëson kontrollin dhe transparencën, duke rritur rrezikun për keq menaxhim dhe dëmtime të resurseve pyjore, si dhe pengon menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të pyjeve publike.

Mos angazhimi me kohë i grupeve punuese për hartimin e udhëzuesëve nga MBPZHR-ja ka shkaktuar vonesa të konsiderueshme në miratimin e udhëzimeve administrative për pyjet, duke mos përmbushur kështu obligimet ligjore. Mungesa e të cilave nuk jep siguri për efektivitetin e zhvillimit të aktiviteteve të Agjencisë Pyjore dhe nuk siguron menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në vend.

### 3.1.2 Mos arritja e objektivave të Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë

*MBPZHR-ja, ka zhvilluar Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë (SZHP) 2022–2030. Synimi parësor i SZHP-së, është që të ruaj, të zgjeroj dhe të siguroj menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore të Kosovës, me qëllim që të kontribuojnë në ekonominë kombëtare.<sup>13</sup>*

Raporti MBPZHR-së për zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë për vitet 2022-2024, tregon se nga 70 objektiva, 28 objektiva janë realizuar, 26 objektiva nuk janë realizuar ndërsa 16 janë realizuar pjesërisht. Ky tregues është i rëndësishëm duke ditur faktin që Strategjia është dokumenti kryesor i politikave pyjore, me synim parësor të ruaj, të zgjeroj dhe të siguroj menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore të Kosovës.<sup>14</sup>

*Tabela 2. Realizimi i objektivave të strategjisë për pyje sipas planit të veprimit 2022-2024.*

| Objektivat sipas nivelit të realizimit | Numri     |
|----------------------------------------|-----------|
| Të realizuara                          | 28        |
| Të Pa realizuara                       | 26        |
| Pjesërisht të realizuara               | 16        |
| <b>Numri total i objektivave</b>       | <b>70</b> |

Të dhënat për gjendjen e zbatimit të objektivave/politikave MBPZHR-ja i siguron nga Agjencia Pyjore, mirëpo gjatë analizës së raporteve të regjistrimit të terreneve Pyjore (2020-2023) vërehet se këto të dhëna nuk janë të plota dhe të sakta. Në këtë periudhë kompetencat e shfrytëzimit dhe mbrojtjes ishin nën nivelin komunal ndërsa regjistrimin e terreneve pyjore e zhvillonin komisionet e përbashkëta nga komuna dhe Agjencia Pyjore. Edhe raportet e inspektoratit tregojnë se raportet e Agjencisë Pyjore nuk janë të sakta, si në rastin e regjistrimeve të terreneve, qiradhënieve etj.

Sipas MBPZHR-së shkaqet për mos realizimin e këtyre objektivave janë kapacitetet e ulëta teknike dhe institucionale, infrastruktura joadekuate, bashkërendimi dhe bashkëpunimi i pasuksesshëm ndërmjet institucioneve përkatëse, kapaciteti i pamjaftueshëm financiarë etj.

Një çështje tjetër është mungesa e komunikimit në mes institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve. Departamenti i Pylltarisë dhe Inspektorati i Pyjeve nuk kanë koordinim ndërmjet tyre për shkëmbim të informatave me qëllim të realizimit të politikave për zhvillimin

<sup>13</sup> Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë (2022-2030)

<sup>14</sup> Raporti i zbatimit PV 2022-2024 për vitin 2023

e qëndrueshëm të pyjeve, duke e ditur që Departamenti i Politikave është përgjegjës për zhvillimin e tyre, ndërsa Inspektorati është garantues i zbatimit të tyre. Sipas Departamentit të Pyjeve, nuk ka ndonjë linjë të komunikimit ndërmjet tyre dhe se raportimet e aktiviteteve bëhen vetëm tek nivelet e larta të MBPZHR-së.

Komunikimi ndërmjet dy akterëve është i rëndësishëm, sepse departamenti që zhvillon politikat duhet të ketë njohuri për gjendjen e zbatimit të tyre në terren. Në këtë mënyrë, Inspektorati do të duhej të siguroj këto të dhëna. Mungesa e këtij komunikimi reflekton në mungesë të njohurive për nivelin e zbatimit të ligjeve dhe politikave për pyje.

### 3.1.3 Mungesa efikasitetit të Inspektoratit të MBPZHR-së në mbrojtjen e pyjeve

*MBPZHR përmes inspektionit të pyjeve sigurohet në: mbikëqyrjen e gjitha aktiviteteve menaxhuese që kryhen në pyje, objektet e punës, mjetet dhe të gjitha vendet ku bëhet deponimi, përpunimi dhe qarkullimi i prodhimeve pyjore, mbikëqyrjen e realizimit të planeve menaxhuese, kontrollojnë dokumentacionin e damkosjes dhe origjinës së prodhimeve pyjore.<sup>15</sup>*

Inspektorati qendror i pyjeve funksionon në kuadër të MBPZHR dhe ka në dispozicion rreth 12 inspektorë të organizuar nga dy për gjashtë regjione të vendit (Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë). Deri në vitin 2023 ky inspektorat ka qenë i vendosur dhe ka funksionuar në kuadër të Agjencisë së Pyjeve<sup>16</sup>. Kryeshefi i Agjencisë pyjore e ka përzgjedhur Inspektorin e pylltarisë. Në këtë mënyrë aktiviteti i inspektoratit nuk ka garantuar kryerjen e inspektimeve në mënyrë të pavarur dhe transparente. Andaj, funksionimi i inspektoratit në kuadër të Agjencisë Pyjore dhe në të njëjtën kohë inspektimi i aktiviteteve të Agjencisë kishte ngritur shqetësimin për konfliktin e mundshëm të interesit. Për këtë arsye në vitin 2013 Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka nxjerrë rekomandim për Qeverinë e Kosovës ku theksohej heqja e inspektoratit nga Agjencia e Pyjeve për arsye se paraqiste konflikt interesi. Për këtë rekomandohej krijimi i Departamentit të Inspektoratit në MBPZHR. Mirëpo kjo nuk kishte ndodhur për rreth 10 vite apo deri në vitin 2023.

Transferimi i tij në Ministri në vitin 2023 është bërë me memorandum mirëkuptimi ndërmjet Agjencisë Pyjore dhe MBPZHR, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pyje. Megjithatë, funksionimi i inspektoratit në MBPZHR nuk është përfshirë në organizimin e ministrisë dhe ende nuk është krijuar bazë rregullative për funksionimin e tyre në kuadër të Ministrisë.

Inspektorati në vazhdimësi ka bërë shkresa të nivelet përgjegjëse lidhur me gjendjen e pyjeve në vend.

Inspektimet realizohen në dy forma:

- *Inspektimet e planifikuara*—të cilat bazohen në planifikimin vjetor. Në këto inspektime përcaktohen fushat dhe periudhat kohore në të cilat do të realizohen kontrollet, si për shembull: shfrytëzimi i pyjeve, guroret, qiradhëniet, etj.

<sup>15</sup>Ligji nr.08/l-137 Për Pyjet

<sup>16</sup>Rregullore QRK-nr.16/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës



- *Inspektimet e paplanifikuara*—të cilat realizohen në raste kur inspektorët njoftohen (sinjalizohen) nga palë të jashtme për aktivitete të dyshimta që mund të rrezikojnë pyjet dhe tokat pyjore.

Inspektorati nuk ka pasur ndonjë metodë të caktuar për përzgjedhjen e mostrës për inspektim të planifikuar, por me ligjin e ri, është hartuar udhëzuesi për inspektimet e bazuara në rrezik.

Për më tepër, inspektimet e qiradhënies në vitin 2024 ishin paraparë të fokusohen në sektorin minerar i kategorizuar me rrezikshmëri të lartë. Kjo ka bërë që fushat tjera nga qiradhënia të mbeten pothuajse të pa inspektuara, duke krijuar boshllëk në mbikëqyrjen e shfrytëzimit të pronës publike dhe duke rritur rrezikun për parregullsi apo keq menaxhim. Kryeinspektori është arsyetuar se kjo fushë nuk paraqet rrezik të lartë dhe për shkak të mungesës së inspektorëve jemi fokusuar sipas prioriteteve mirëpo në rast të marrjes së informacioneve për keqpërdorim të pronës publike atëherë zhvillohen inspektimet e jashtëzakonshme. Mirëpo, pas inspektimit të këtyre fushave kanë rezultuar me parregullsi dhe shfrytëzime jashtë kriterëve dhe të paligjshme të pyjeve.

Kjo praktikë nuk siguron kryerjen e inspektimeve, në mënyrë efikase dhe transparente si dhe paraqet rrezik për dëmtimin e hapësirave pyjore në pronën publike.

Gjatë zhvillimit të inspektimeve të planifikuara inspektorët në disa raste vërejnë aktivitete të dyshimta apo pranojnë informata nga sinjalizuesit për të cilat bëjnë kërkesa për të filluar inspektim. Për të vazhduar procesin e inspektimit të paplanifikuar inspektorët duhet të marrin autorizim nga udhëheqësi/kryeinspektori. Por sipas tyre kryeinspektori në disa raste nuk ka dhënë miratim për inspektimet të pa planifikuara.

Në regionin e Mitrovicës, është evidentuar një rast i raportuar nga sinjalizuesit për dyshimin e keqpërdorimit gjatë hartimit të planeve menaxhuese në kuadër të Agjencisë Pyjore. Dyshimi lidhet me dhënien e dy kontratave për hartimin e planeve menaxhuese afatgjata gjatë viteve 2023/2024. Këto kërkesa për autorizim të inspektimeve ishin refuzuar me arsyetimin se nuk i plotësojnë kriteret e inspektimit sipas ligjit për inspektime<sup>17</sup> dhe kjo lëndë ishte trajtuar nga organet kompetente. Në regionin e Prishtinës, ka pasur informata për shtatë kontrata të qiradhënies për të cilat ka pasur indikacione se janë dhënë pa i plotësuar kriteret e nevojshme, si dhe një rast i raportuar nga sinjalizuesi i cili pretendon se një operator përdor masë drusore pa origjinë. Rastet e Prishtinës dhe rasti i Mitrovicës nuk janë miratuar për inspektim nga kryeinspektori me arsyetimin se nuk janë diskutuar me menaxhmentin për të konstatuar dyshimet si dhe nuk janë plotësuar sipas kërkesës ligjore për inspektime të jashtëzakonshme. Ndërkohë një inspektim i jashtëzakonshëm/paplanifikuar është miratuar/kryer dhe ka rezultuar me parregullsi si në vijim.

<sup>17</sup> Ligji Nr. 08/L-067 Për Inspektimet

Foto 1. Shfrytëzimi i masës pa origjinë drusore për tallash<sup>18</sup>

Rasti ka të bëjë me një kompani e cila ka operuar fillimisht në Lipjan e mandej në Mitrovicë, dhe shfrytëzonte masën drusore për industri-lëndë të parë për prodhimin e kërpudhave. Inspektorët kanë inspektuar atë në fund të vitit 2023 dhe kanë kërkuar dëshmi për origjinën e masës drusore, por nuk i kanë siguruar/pranuar. Në muajin shkurt të vitit 2024, inspektorët kishin kërkuar autorizim për të realizuar një inspektim të përsëritur, por fillimisht ishte refuzuar nga kryeinspektori.

Autorizimi për të kryer inspektimin është dhënë në muajin prill të vitit 2025, gjatë procesit tonë auditues. Raporti inspektimit tregon se, kompania kishte deklaruar se masa drusore e shfrytëzuar ishte dru zjarri, dhe se kompania në vazhdimësi është furnizuar nga persona privat dhe nuk e ka verifikuar nëse drunjtë janë të damkosur dhe nëse posedojnë dokumentacion.

Sipas raportit të inspektorëve kjo kompani kishte theksuar se për një javë shpenzon afërsisht 30m<sup>3</sup>, që për një vit shpenzon rreth 1,440m<sup>3</sup>, masë drusore, që i bie pa dokumentacion mbulues.

Mos trajtimi efikas i inspektimeve që rrjedhin nga sinjalizimet tregon mungesë të efikasitetit në funksionimin e inspektoratit dhe cenon besimin e qytetarëve dhe sinjalizuesve në institucionet publike. Kjo situatë mund të krijojë perceptimin se operatorët mund të keqpërdorin pronat publike dhe të mos mbikëqyren, inspektohen apo ndëshkohen. Mos përgjigjja ndaj kërkesave për inspektim që vijnë si rezultat i informacioneve të brendshme apo të jashtme është në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe përbën rrezik për keqpërdorim të pronave publike, nga qiramarrësit dhe nga shfrytëzuesit ilegalë. Monitorimi i dobët ndaj Agjencisë pyjore dhe inspektoratit ndikon në mungesë të informacionit për dëmet në hapësirat pyjore dhe nuk garanton zbatimin e ligjit të pyjeve në vend.

<sup>18</sup> Lëndë e parë për kultivimin e kërpudhave

### 3.2 Mungesa e masave për mbrojtjen e pyjeve publike

*Asnjë person nuk mund të pres dru në pyjet publike, përveç nëse personi ka licencën të vlefshme, dhe drunjtë, duhet të shënuar para prerjes. Licenca për të prerë drunjtë në një pyll publik është e vlefshme vetëm nëse prerja është në përputhje me planin menaxhues operacional të vlefshme që mbulon atë pyll.<sup>19</sup>*

Nga regjistrimi i terreneve pyjore, të cilat janë zhvilluar nga komunat dhe drejtoritë regionale të Agjencisë Pyjore, është konstatuar se numri i dëmeve pyjore të shkaktuara nga aktivitetet ilegale është shumë i lartë. Sipas ligjit<sup>20</sup> komunat janë të obliguara që se paku një herë në vit të zhvillojnë regjistrime të rregullta, apo të jashtëzakonshme, që realizohen në rast të ndërrimit të rojës së pyllit apo në raste dyshimi nga inspektorët për sasi të mëdha të drunjëve të prerë në mënyrë të paligjshme dhe të raportojnë në Agjencinë Pyjore.

Ky proces është instrument i rëndësishëm për evidentimin dhe eliminimin e veprimeve ilegale dhe dukurive të paligjshme në pyje, por gjithashtu adreson përgjegjësitë dhe obligimet e rojeve të pyllit, duke shërbyer si një mekanizëm mbikëqyrës për performancën e tyre.

Me regjistrimin e të dhënave në rajonet përkatëse, vërtetohet dallimi ndërmjet dëmeve faktike dhe atyre të arsyetuara me fletëparaqitje. Nëse ky ndryshim është më i madh se 20 m<sup>3</sup> në pyjet e larta trungishte, ose 10 m<sup>3</sup> në pyjet e ulëta cungishte, atëherë ndërmerren masa dhe iniciohen procedura kundër rojës së pyllit.

Në vijim paraqitet tabela e regjistrimeve pyjore, e cila reflekton gjendjen e konstatuar sipas raporteve vjetore të Agjencisë Pyjore për vitet 2020–2023, ndërsa për vitin 2024 procesi i regjistrimit është përfunduar mirëpo nuk është përfunduar Analiza e regjistrimit të terreneve pyjore.

Tabela 3. Regjistrimi i terreneve pyjore për vitet 2020-2023.

| Viti | Dëmi i pa arsyetuar (m <sup>3</sup> ) | Dëmi i Arsyetuar (m <sup>3</sup> ) | Dëmi i shkaktuar (m <sup>3</sup> ) | Numri i fletëparaqitjeve (m <sup>3</sup> ) | Numri i terreneve të regjistruara | Numri i terreneve të pa regjistruara | Vlera në euro |
|------|---------------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|--------------------------------------------|-----------------------------------|--------------------------------------|---------------|
| 2020 | 3,513                                 | 5,835                              | 9,349                              | 2423                                       | 168                               | 52                                   | 1,021,158     |
| 2021 | 3,827                                 | 4,626                              | 8,625                              | 1916                                       | 183                               | 37                                   | 1,169,502     |
| 2022 | 4,507                                 | 4,781                              | 9,326                              | 2,403                                      | 183                               | 37                                   | 1,270,011     |
| 2023 | 9,491                                 | 4,372                              | 13,864                             | 2,465                                      | 184                               | 24                                   | 1,895,31      |

Nga tabela më lart shihet se dëmet pyjore për katër vite vlerësohet se kalojnë shifrën prej 5.3 milionë euro, dhe se nuk ka përmirësim të këtij fenomeni ndër vite.

Për më tepër, Agjencia Pyjore në Analizën vjetore të regjistrimeve të terreneve pyjore deklaroi se të dhënat e pranuar nga komunat nuk janë të plota dhe nuk paraqesin gjendjen reale edhe pse në përbërje të komisionit për regjistrim të terrenit kishte edhe zyrtar nga Agjencia Pyjore. Ka shumë faktor që ndikojnë në raporte të mangëta të regjistrimit të terreneve pyjore si: numri i madh i terreneve pyjore të paregjistruara ndër vite për shkak të mos koordinimit ndërmjet

<sup>19</sup> Ligji nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, neni 20

<sup>20</sup> ligji nr. 03/l-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës

Agjencisë Pyjore dhe nivelit komunal për mbrojtjen e pyjeve, niveli i ulët i regjistrimit të dëmeve pyjore në zonat e ndjeshme, raportimi për dëmet pyjore në nivel kufitar që nuk e ngarkon rojën e pyllit me përgjegjësi dhe nuk mund të fillohen procedurat disiplinore kundër tij, vërtetimi jo i saktë i numrit të fletëparaqitjeve në gjykatë, dokumentacioni i pakompletuar dhe gabime teknike në formularët e regjistrimit.

Faktin që raportet vjetore për regjistrimin e terreneve pyjore nuk janë të plota dhe reale e tregojnë edhe raportet e Inspektoratit.

1. Në rastet e paraqitura më poshtë si mostër, Inspektorati ka obliguar komunat formimin e komisioneve të përbashkëta me njësitë regionale të Agjencisë Pyjore për regjistrimin e jashtëzakonshëm të terreneve të caktuara pyjore apo monitorim të hapësirave pyjore, për shkak të dyshimit se nuk është paraqitur gjendja reale: Gjatë inspektimeve në regjionin e Prishtinës të vitit 2022, Inspektorati kishte nxjerrë vendim për vlerësimin e dëmit pyjor të shkaktuar në Komunën e Drenasit, dhe kishte obliguar formimin e komisionit të dytë me arsyetimin se komisioni i parë nuk e kishte paraqitur gjendjen reale të dëmeve pyjore. Komisioni i parë kishte raportuar dëme të përgjithshme 25 m<sup>3</sup>, kurse nga raporti i komisionit të dytë dëmi ishte 180 m<sup>3</sup>. Më tej kjo lëndë ishte trajtuar nga organet kompetente.
2. Në vitin 2021 është obliguar regjistrimi i të gjithë terrenit të Vitisë për shkak të parregullsive të konstatuara nga ana e inspektorëve në regjionin e Gjilanit, ku cungjet ishin pa damka (vulosja e drunjëve) të dëmit pyjor dhe pa damka të kontrollit pyjor dhe nuk ishin të evidentuar me numra rendor siç parashihet me legjislacion.
3. Në vitin 2023, inspektorët kanë pranuar raportin e komisionit për mbikëqyrjen e kontratave në regjionin e Pejës. Pas analizimit Inspektorati kishte dyshuar se nuk është paraqitur gjendja reale e shfrytëzimit të pronës publike nga një operator. Nga inspektorati është kërkuar që të bëhet edhe një herë monitorimi i kontratës, njësia regjionale kishte përgatitur raportin plotësues ku gjendja e paraqitur dallonte nga raporti i parë i monitorimit sepse operatori kishte tejkaluar hapësirën e shfrytëzimit të kontratës për 1.65 ha.
4. Inspektorati kishte iniciuar regjistrim të jashtëzakonshëm në vitin 2021 në komunën e Lipjanit për shkak se kishte hasur prerje ilegale të pyjeve. Përveç kësaj, ishin bërë përpjekje për fshehje të dëmeve pyjore, pasi kishte raste kur jo vetëm degët dhe mbetje të tjera ishin përdorur për të mbuluar cungjet, por edhe materiale të tjera inerte.

Gjatë shqyrtimit të aktiviteteve të Inspektoratit Pyjor dhe strukturave komunale në disa regjione, ishin identifikuar raste të theksuara të mospërputhjes ndërmjet raporteve zyrtare dhe gjendjes faktike në terren. Sipas vlerësimit të Inspektoratit Pyjor, regjistrimi i terreneve pyjore nuk është kryer në mënyrë të saktë dhe të besueshme në disa raste. Kjo dukuri përbën një shqetësim të vazhdueshëm, duke qenë se është e pamundur të inspektohen të gjitha terrenet për shkak të sipërfaqes së madhe. Për më tepër, mënyra aktuale e regjistrimit nga komisionet ka treguar mungesë objektiviteti dhe besueshmërie.

Këto mangësi kontribuojnë në devijime të konsiderueshme ndërmjet regjistrimeve dhe gjendjes reale në terren, duke rritur rrezikun për keqmenaxhim të resurseve pyjore, manipulim të të dhënave dhe dëmtime të paidentifikuara apo të mbuluara.

Sipas Ligjit<sup>21</sup> për pyje, deri në vitin 2023, mbrojtja e pyjeve ishte përgjegjësi e komunave dhe në disa raste komunikimi komunave me Agjencinë nuk ka qenë në nivelin e duhur.


Këto raste tregojnë për dobësi të theksuara në mekanizmat e mbikëqyrjes, dokumentimit dhe raportimit nga autoritetet përgjegjëse respektivisht komunat dhe Agjencia Pyjore. Mospërputhjet ndërmjet raporteve dhe gjendjes në terren, rrisin rrezikun për keqpërdorim të pasurisë publike dhe dëmtojnë besueshmërinë e procesit të kontrollit pyjor dhe menaxhimit të kontratave.

**Rojet e pyjeve**, kanë për obligim ta organizojnë orarin e tyre prej tetë orësh brenda një dite bazuar në vlerësimin e rrezikut. Megjithatë ne nuk kemi vërejtur se rojet e pyjeve bëjnë vlerësim të rrezikut dhe organizojnë punën e tyre bazuar në këtë vlerësim. Duke marrë parasysh edhe faktin se hapësira e mbuluar nga një roje është e madhe dhe rrezikshmëria në punë është e lartë, tregon se organizimi i mbrojtjes së pyjeve është i dobët dhe mbrojtja e pyjeve publike përmes rojeve të pyllit nuk është në nivelin e duhur. Sipas raporteve prerjet ilegale në shumë raste kanë ndodhur jashtë orarit të angazhimit të tyre brenda orarit 8 orësh. Agjencia Pyjore posedon tre dronë, përmes të cilëve do të duhej të vëzhgohen pyjet dhe prerjet potenciale në çdo kohë. Agjencia pohon se dy dronë janë të cilësisë së lartë dhe për t'i përdorur duhet të merret leje paraprake nga institucionet e sigurisë e cila kërkon kohë.

**Zjarret**, janë një fenomen tjetër i rrezikshëm që paraqitet në masë të madhe në pyje. Agjencia Pyjore thekson se djegiet e pyjeve në shumicën e rasteve ndodhin nga faktori njeri si pakujdesia dhe piromania apo temperaturat e larta dhe shkaqe tjera. Andaj mungesa e ruajtjes së hapësirave pyjore krijon hapësirë për dëmtimin dhe keqpërdorimin e pyjeve si dhe pamundëson eliminimin/kontrollin e shkaktarëve që dëmtojnë pyjet.

Të dhënat e pranuar nga Agjencia Pyjore për rastet e djegieve të pyjeve, janë paraqitur më poshtë në tabelë.

Grafiku 2. Sasia e djegies së pyjeve për periudhën 2020-2024



Nga grafiku më lartë shihen sasia e masës drusore të djegur ku për pesë vitet e fundit është 10,451 ha. Ky fenomen shkakton dëme shumë të mëdha të pyjeve në vend, sepse përveç

<sup>21</sup> Ligji nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës



humbjes së masës drusore, pyjet e djegura janë vatër e infektiveve nga sëmundjet e ndryshme.

### 3.2.1 Menaxhimi jo efektiv i Parqeve Kombëtare

*Sektorët për Shërbime Profesionale dhe Administrative në AMMK duhet të kujdeset ndaj resurseve natyrore të Parqeve Kombëtare dhe ndalimi i veprimeve ilegale, prerjet e pyjeve, gjuetinë, peshkimin, ndërtimin e objekteve, uzurpimin e pronave dhe identifikojnë personat që bëjnë vepra ilegale.<sup>22</sup>*

*Aktivitetet për parqet kombëtare duhet të bëhen në bazë të planit menaxhuese të pyjeve. Ky Plan hartohet nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe miratohet nga MBPZHR, me pëlqimin e Ministrisë përgjegjëse për Mjedis.*

#### Parku kombëtar Bjeshkët e Nemuna

Në territorin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” ndër problemet më të mëdha pas prerjeve ilegale janë ndërtimet legale që vazhdimisht paraqitën që nga viti 2000.

Drejtoria e Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” menaxhon me sipërfaqe rreth 63 mijë ha dhe sipas drejtorisë, pyjet në këtë Park janë të mbuluara tërësisht me roje të pyllit. Sipas ligjit për pyje Agjencia Pyjore përveç planeve menaxhuese për pjesët e sajë ajo duhet ta përgatisë edhe planin menaxhuese për pyjet në parqet kombëtare, mirëpo Agjencia Pyjore ende nuk i ka përfshirë në planet e veta menaxhuese planet për pyjet në parqet kombëtare, për shkak edhe mungesës së buxhetit sipas Agjencisë Pyjore.

Sa i përket ndërtimeve ilegale para se të shpallet Park Kombëtar kanë qenë 2,900 raste të evidentuara në prona publike dhe private, dhe ky fenomen ka vazhduar edhe gjatë viteve të menaxhimit nga Drejtoria e Parkut. Aktualisht sipas regjistrimeve të drejtorisë së parkut të vitit 2024 janë gjithsej 6,083 ndërtime, prej tyre 3,362 në prona private dhe 2,721 në prona publike, disa nga të cilat janë shfrytëzuar tradicionalisht nga banorët vendas. Sa i përket vendimeve të gjykatave për rrënim kemi 94 vendime për rrënime në hapësira të pronës publike. Sipas AMMK-së vazhdimi i ndërtimeve ilegale në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, ka vazhduar në mungesë të Planit Hapësinore për këtë territor dhe Planeve Rregulluese për zonat e caktuara.

Tabela 4. Kallëzime penale për ndërtimet në Bjeshkët e Nemuna

| Viti                          | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|-------------------------------|------|------|------|------|
| Kallëzime penale për ndërtime | 215  | 170  | 185  | 217  |

Nga tabela më lartë shihet se aktivitetet e ndërtimeve brenda parkut janë të vazhdueshme edhe pse drejtoritë e parkut paraqesin kallëzime penale në gjykatë.

Problematikë tjetër janë prerjet ilegale të pyjeve në parqet kombëtare. Inspektorati i mbrojtjes së natyrës i MMPH-së në vitin 2020 kishte inspektuar disa lokacione në Parkun Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”. Inspektorët kishin hasur në një lokacion për masë drusore ku damkimi nuk ishte në rregull. Pas analizimit të dokumentacionit të lëshuar nga drejtoria e “Bjeshkëve të Nemuna” e cila kishte potencuar se masa drusore është miratuar për dru zjarri, por, sipas gjendjes së konstatuar nga inspektorët, masa drusore mbi dy metër nuk destinohet për dru zjarri por për dru teknik industrial, ku dhe si pasojë inspektorati kishte dhënë vërejtje.

Gjatë viteve 2021–2024 Drejtoria e Parkut Kombëtar ka paraqitur gjithsej 140 fletëparaqitje për prerje ilegale të drunjve dhe janë konfiskuar masës drusore prej 547 m<sup>3</sup>.

<sup>22</sup> Rregullore (QRK)-nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të MMPH



Mungesa e mbikëqyrjes së duhur të rojeve të pyllit ka shkaktuar që pyjet dhe hapësirat pyjore në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna të shkatërrohen dhe degradohen.

### Parku Kombëtar Sharri

Sipas AMMK-së drejtoria e Parkut Kombëtarë “Sharri” ka një sipërfaqe rreth 54 mijë ha. Përveç mungesës së planeve menaxhuese drejtoria e Parkut “Sharri” përballet edhe me vështirësi të tjera si: mungesa e rojeve, prerjet ilegale, ndërtimet pa leje si dhe mungesa e pastrimeve sanitare.

Drejtoria përkatëse ka të mbuluar me roje të pyllit vetëm rreth 30% të territorit të saj, duke lënë pjesën më të madhe të sipërfaqes pa mbikëqyrje të rregullt. Gjendje më e rëndë paraqitet në komunat e Dragashit, Shtërpçës dhe Kaçanikut ku rreth 70% e territorit nuk është fare e mbuluar me roje pylli. Kjo ka ndikuar që në këto territore të paraqitet gjendja e rëndë për shkak të prerjeve ilegale si pasojë e mungesës së rojeve. Në mungesë të rojeve të pyllit AMMK çdo vit angazhon praktikant me kontrata të përkohshme, por sipas drejtorisë së Parkut, kjo zgjidhje nuk ka dhënë rezultate e pritura në ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve.

Tabela 5. Aktivitetet ilegale në Parkun “Sharri”

| viti | Fletë paraqitje për prerje ilegale | Konfiskimi i masës drusore | Prerjet ilegale |
|------|------------------------------------|----------------------------|-----------------|
| 2021 | NA                                 | 86.79 m3                   | 2,252 m3        |
| 2022 | 39                                 | 71.19 m3                   | 2,255 m3        |
| 2023 | 53                                 | 58.95 m3                   | 3,247 m3        |
| 2024 | 65                                 | 59.03 m3                   | 5,850 m3        |

Nga tabela më lartë shihet një rritje e vazhdueshme e aktiviteteve të paligjshme në pyje, si në numër të fletë-paraqitjeve ashtu edhe në sasinë e prerjeve ilegale. Megjithatë, masa e konfiskuar mbetet në nivel shumë të ulët.

Sipas kallëzimeve penale për ndërtimet ilegale Drejtoria e Administrimit të Parkut Kombëtar “Sharri” ka regjistruar gjithsej 85 ndërtime ilegale nga viti 2020-2024, prej tyre rreth 40 të ndërtuara në pronat publike.

Gjithashtu, pyjet në gjithë territorin e parkut “Sharri” në vazhdimësi rrezikohen edhe nga faktorë të tjerë si: zjarret, fatkeqësitë natyrore, sëmundjet bimore, insektet dëmtues etj. Me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pyjeve sipas Rregullores së brendshme parashihen prerjet dhe pastrimet sanitare. Deri në vitin 2023 drejtoria e parkut “Sharri” ka kryer aktivitetet e pastrimeve sanitare të pyjeve të dëmtuara nga zjarret, fatkeqësitë natyrore, insektet dëmtues dhe sëmundjet bimore. Nga viti 2023 nuk janë zhvilluar aktivitetet e pastrimit të pyjeve publike në parqet kombëtare, si rezultat i ndërthurjes së kompetencave menaxhuese pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pyjet. Sipas Drejtorisë përkatëse, kjo situatë ka krijuar pasiguri institucionale për zbatimin e përgjegjësisë operacionale, duke rrezikuar menaxhimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e ekosistemit në zonat e mbrojtura. Mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe atyre të parqeve kombëtare përbën rrezik të vazhdueshëm për neglizhencë funksionale dhe degradim mjedisor.

Mosrealizimi i trajtimi të pyjeve në zonat e parqeve kombëtare paraqet rrezik të drejtpërdrejt të biodiversiteti, duke ndikuar negativisht në ruajtjen e specieve dhe ekosistemeve të mbrojtura. Këto zona, përveçse përbëjnë parqe kombëtare, karakterizohen edhe nga cilësi e lartë e pyjeve, që përbën një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit malor dhe qëndrueshmërinë ekonomike lokale. Mungesa e ndërhyrjeve për pastrim dhe menaxhim aktiv

të pyjeve në këto zona rrezikon si funksionin ekologjik të tyre, ashtu edhe mundësinë për shfrytëzim të qëndrueshëm ekonomik.

### Mungesa e trajtimit të sëmundjeve të shfaqura në pyjet e parqeve kombëtare

*Sektorët për Shërbime Profesionale dhe Administrative në AMMK duhet të kujdeset ndaj resurseve natyrore të Parqeve Kombëtare dhe ndalimi i veprimeve ilegale.<sup>23</sup>*

*Agjencia Pyjore dhe pronarët e pyjeve private janë të obliguar që të monitorojnë gjendjen e shëndetit të pyjeve dhe të ndërmarin masat e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve që rrezikojnë pyjet. Agjencia Pyjore, në bashkëpunim me institucionet tjera siguron realizimin e aktiviteteve për mbrojtjen e shëndetit të pyjeve.<sup>24</sup>*

Rreth 3% e pyjeve të parkut kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është e prekur nga sëmundje të ndryshme të pyjeve që janë paraqitur para shumë vitesh, por deri tani nuk janë ndërmarre masa nga institucionet përgjegjëse. MMPHI dhe MBPZHR ende nuk kanë arritur koordinim për trajtimin e pyjeve brenda parqeve kombëtare.

Nga viti 2019, në vazhdimësi komunat në të cilat gjinden parqet kombëtare kanë shprehur shqetësim lidhur me mos trajtimin e sëmundjeve në pyjet brenda parqeve kombëtare. Kërkesën për trajtim e kishin drejtuar në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) në kuadër të MMPHI-së. Ky institut i kishte rekomanduar Agjencisë Pyjore që menjëherë të ndërmarre masa për eliminimin e këtyre dëmtuesve në këto zona në mënyrë që të shmanget përhapja e tyre në zonat tjera.

Kërkesë e tillë ishte paraqitur edhe në Institutin Pyjor të Kosovës i cili kishte dhënë rekomandimin që AMMK, konkretisht Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", të gjejë rrugët ligjore për heqjen e kësaj mase të tharë drusore nga ato sipërfaqe dhe të rekomandojë prerjen sanitare, që nënkupton prerjen dhe heqjen e masës drusore të tharë nga insektet. Ndërhyrja dhe prerje sanitare lejohet në pyjet e Parqeve Kombëtare, në zonën e dytë dhe të tretë, ku masa drusore përdoret si dru zjarri për komunitetin lokal, deri në 12 m<sup>3</sup> në vit për familje. Ndërsa këto prerje janë të ndaluara në zonën e parë të mbrojtjes.<sup>25</sup>

Ky kufizim është cekur në Ligjin për mbrojtjen e natyrës<sup>26</sup> dhe Rregulloren<sup>27</sup> për rendin e brendshëm të Parqeve Kombëtare, veçanërisht duke marrë parasysh faktin që një pjesë e konsiderueshme e zonave të dëmtuara gjenden brenda zonës së parë dhe të dytë të mbrojtjes.

Për të mundësuar trajtimin e këtyre sëmundjeve, AMMK në vitin 2022 kishte tentuar të ndryshojë Rregulloren për rendin e brendshëm të Parqeve Kombëtare, përmes së cilës do t'i lejohej prerja e masës drusore mbi 12 m<sup>3</sup>. Për ndryshimin e kësaj rregulloreje kërkohet pëlqim nga ana e MBPZHR, por sipas AMMK-së ky pëlqim nuk ishte dhënë. Shkak për mungesën e trajtimit të sëmundjeve nga institucionet përgjegjëse është mungesa e vullnetit për koordinim të aktiviteteve për ruajtjen e pyjeve në parqet kombëtare.

Në vijim kemi paraqitur disa foto të gjendjes së pyjeve në parqet kombëtare, ku shihet se një pjesë e madhe e pyllit në këto parqe është e infektuar nga kjo sëmundje.

<sup>23</sup> Rregullore (QRK)-nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të MMPH

<sup>24</sup> Ligji Nr.08/L-137 Për Pyjet, neni 37

<sup>25</sup> Rregulloren Nr. 21/2013 për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtar

<sup>26</sup> Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës

<sup>27</sup> Rregulloren Nr. 21/2013 për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtar

Foto 2. Dëmtimi i pyjeve nga insektet



Burimi: Instituti Pyjor i Kosovës

Mungesa e koordinimit ndërinstitutional dhe kufizimet ligjore për ndërhyrje në zonat e mbrojtura kanë rezultuar në përkeqësimin e gjendjes së pyjeve në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Mos ndërmarrja e masave të nevojshme rrezikon përhapjen e dëmtuesve në zona të tjera, duke kërcënuar biodiversitetin. Për më tepër, mos dhënia e pëlqimeve institucionale për ndryshime rregullative tregon mungesë vullneti për të ndërmarrë veprime konkrete për mbrojtjen e resurseve pyjore.

### 3.2.2 Uzurpimi i pronave të cilat i menaxhon Agjencia Pyjore

Ministria miraton një plan të ri për secilin rajon të pyjeve publike së paku një herë në 10 vjet. Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.<sup>28</sup>

Shumica e rasteve të shfrytëzimeve të pa autorizuar apo uzurpimeve të pronave nuk janë të identifikuar.

Shumë prej shfrytëzimeve të pa autorizuar janë shfrytëzuar me gjenerata nga banorët vendas për të cilat kanë qenë të njoftuara institucionet përgjegjëse por që kanë munguar masat për trajtimin e tyre. Po ashtu, ka edhe uzurpime të reja e të cilat ndodhin për shkak të mungesës së monitorimit nga drejtoritë regjionale.

Në vijim kemi paraqitur të dhënat e dorëzuara nga njësit regjionale lidhur me rastet e uzurpimeve në regjionet e tyre.

Tabela 6. Lista e uzurpimeve të dorëzuara nga drejtorit koordinuese regjionale

| Njësia regjionale | Data e Raportit | Nr. Parcelave të uzurpuara | Kallëzime penale | Lirimi i pronës |
|-------------------|-----------------|----------------------------|------------------|-----------------|
| Ferizaj           | 19.05.2023      | 55                         | 22               | -               |
| Prishtinë         | 24.05.2023      | 22                         | 3                | -               |
| Gjilan            | 17.05.2023      | 43                         | 3                | -               |
| Mitrovicë         | 04.06.2024      | 4                          | 3                | -               |

<sup>28</sup> Rregullore MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore

|               |            |            |            |           |
|---------------|------------|------------|------------|-----------|
| Prizren       | 31.01.2025 | 94         | 73         | 21        |
| Pejë          | 23.11.2021 | 28         | -          | -         |
| <b>Totali</b> |            | <b>246</b> | <b>104</b> | <b>21</b> |

Siç paraqitet në tabelën më lartë, numri i rasteve të raportuara nga drejtoritë koordinuese regionale për uzurpime në vendin tonë për vitet 2020-2024 është 246. Të dhënat më lartë nuk paraqesin gjendjen reale të pronave të uzurpuara sepse komunat dhe drejtoritë koordinuese të Agjencisë nuk i kanë monitoruar pronat nën menaxhimin e tyre dhe nuk kanë dorëzuar raporte për territorin që e mbulojnë.

Si shembull është rasti i një operatori i cili kishte lidhur kontratën e qiradhënies në vitin 2017 për shfrytëzimin e inerteve në një sipërfaqe prej 5 ha mirëpo inspektorët kishin vërejtur dy hektar në afërsi të tij që ishin shfrytëzuar nga i njëjti operator për 18 vite në mënyrë të pa autorizuar. Për këtë shkelje, inspektorati kishte detyruar subjektin të paguajë 73,000€ në mënyrë retroaktive për periudhën 2004-2022, duke lidhur edhe marrëveshjen në vitin 2022.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për pyje, Agjencisë Pyjore i është mundësuar që të gjithë uzurpatorët apo shfrytëzuesit e paautorizuar të pronave publike të aplikojnë për të lidhur kontratë për qiradhënie me qëllim të shfrytëzimit të hapësirave pyjore. Gjatë këtij procesi Agjencia Pyjore kishte pranuar 2,242 aplikime. Mirëpo, ky proces u pezullua për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronat Publike i cili e parashihte themelimin e Njesisë për Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit.

Megjithëse ky numër i aplikimeve mund të mos pasqyroj situatën reale, pasi ka dallim të lartë ndërmjet numrit të raportuar prej 246 dhe numrit të aplikimeve 2,242, dallimi mund të jetë edhe më i lartë duke marrë parasysh se jo të gjithë shfrytëzuesit e paautorizuar mund të jenë informuar për mundësinë e aplikimit.

### 3.2.3 Agjencia Pyjore nuk ka informacione të plota për pronat të cilat i menaxhon

*Agjencia duhet të kontrollojë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare.<sup>29</sup>*

Agjencia Pyjore ende nuk e ka listën me detajet e pronave nën menaxhim si dhe ende nuk ka bërë unifikimin e pronave të cilat i menaxhon. Ato vazhdojnë të jenë të regjistruara në emër të ish-ndërmarrjeve ekonomike pyjore, të rreth 500 subjekteve të ndryshme.

Agjencia Pyjore nuk e ka arsyetuar mos mbajtjen e listave të pronave për mbi 20 vite të menaxhimit të tyre. Viteve të fundit kishte tentuar të unifikonte pronat, por sipas saj hyrja në fuqi e Ligjit për Pronën Publike ka sjellë paqartësi/pengesa.

Agjencia Pyjore dhe akterët tjerë përgjegjës nuk kanë informacione të sakta mbi vendndodhjen dhe koordinatat e pronave pyjore të menaxhuara nga Agjencia Pyjore. Kjo ka ndikuar që shumë prej këtyre pronave të uzurpohen apo të shfrytëzohen në mënyrë të paautorizuar, duke sjellë pasoja të konsiderueshme mjedisore dhe ekonomike/sociale.

Përveç ndikimeve mjedisore, uzurpimi ka shkaktuar humbje financiare për buxhetin e shtetit, pasi hapësirat pyjore janë përdorur pa kontrata. Gjithashtu, mos funksionalizimi i Njesisë për

<sup>29</sup> Rregullore MF – nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore



Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit ka ndikuar në vazhdimin e shfrytëzimit të paautorizuar apo të uzurpimit të hapësirave pyjore si dhe tejkalimin e afateve kohore të shfrytëzimit të kontratës së qiradhënies.

Agjencia ende nuk e ka bërë funksionalizimin e kadastrit të pyjeve siç parashihet në ligjin për pyjet përkundër angazhimeve në këtë drejtim.

Funksionalizimi i kadastrit të pyjeve do të ndihmonte në menaxhimin si duhet të hapësirave pyjore, njohuri të sakta për vendndodhjen e pronave, me qëllim të ndalimit të uzurpimit apo zhvillimit të aktiviteteve ilegale. Në këtë drejtim, Agjencia Pyjore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, do të duhej të mbajë dhe të përditësojë të dhënat mbi elementet e kadastrës pyjore përmes Sistemit Informativ për Pyjet e Kosovës, duke siguruar një menaxhim më efikas dhe transparent të këtyre hapësirave<sup>30</sup>.

Mungesa e kadastrit pyjor nuk e arsyeton mos menaxhimin e pronave publike në mënyrën e duhur për shkak se Agjencia Kadastrale i ka të gjitha të dhënat kadastrale për të gjitha pronat në vend, madje ka mbajtur trajnim për këtë fushë për zyrtaret e Agjencisë Pyjore duke i dhënë edhe qasje në sistemin e tyre, i cili i ka të dhënat e plota. Mirëpo Agjencia Pyjore nuk e ka përdorur këtë sistem.

### 3.2.4 Ndryshimet kadastrale të pronave të menaxhuara nga Agjencia Pyjore

*Asnjë person nuk mund të fitojë të drejtën e pronësisë mbi pyjet dhe tokat pyjore shtetërore përmes shfrytëzimit apo uzurpimit.*<sup>31</sup>

Pronat e menaxhuara nga Agjencia Pyjore kanë pësuar ndryshime kadastrale ndër vite. Gjatë analizimit të të dhënave të Agjencisë Kadastrale për këto prona për vitet 2014-2024 kemi gjetur se janë 672 prona me një sipërfaqe prej 11,600 ha, kanë pësuar ndryshime kadastrale. Ndryshimet kanë ardhur për arsye të ndryshme, prandaj për të vlerësuar gjendjen lidhur me këto prona ne kemi zgjedhur 76 mostra nga Drejtoritë Kadastrale të shtatë komunave kryesore.

Tabela 7. Ecuria e ndryshimeve kadastrale të pronave të menaxhuar nga Agjencia Pyjore.

| Qyteti  | Gjendja                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ferizaj | Nga analiza e 17 mostrave në komunën e Ferizajt kemi identifikuar se 14 prona janë shitur përmes procesit të privatizimit, dy kanë kaluar në pronësi të komunës së Ferizajt me vendim të Qeverisë dhe një ka kaluar tek personi privat duke u bazuar në aktgjykim të vitit 1990. |
| Gjilan  | Nga Analiza e tri mostrave të ndërrimit të pronarëve dy janë me vendim të Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e Autostradës, ndërsa prona e tretë ka kaluar në pronësi të Komunës së Gjilanit me vendim të Këshillit komunal Gjilan.                                               |
| Gjakovë | Nga analiza e 15 mostrave të ndryshimeve kadastrale kemi identifikuar se 11 prej tyre kanë kaluar në pronësi të Republikës së Kosovës, dy parcela kanë                                                                                                                           |

<sup>30</sup> Ligji Nr.08/L-137 për pyjet

<sup>31</sup> Ligji Nr.08/L-137 për pyjet



|           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|           | kaluar në pronësi të kompanisë së Ujësjetllësit Radoniqi me Aktvendim të vitit 1978, ndërsa dy parcela kanë pësuar ndryshime për shkak të procesit të komasacionit të vitit 2008.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Mitrovicë | Nga analiza e tetë mostrave kemi identifikuar se pesë prej tyre kanë pësuar ndryshime të pronësisë me vendim të Qeverisë për ndërtimin e parkut të erës në Selac, ndërsa tri të tjera kanë pasur ndryshime kadastrale për shkak të shfrytëzimit të pronave përmes qiradhënies për kohë të caktuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Pejë      | Nga analiza e shtatë mostrave të ndryshimeve kadastrale kemi identifikuar se dy parcela kanë pësuar ndryshime kadastrale për shkak se një pjesë e tyre ka kaluar në pronësi të Kuvendit Komunal Pejë me vendim të Qeverisë të vitit 2016. Një parcelë është parcializuar me kërkesë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) në vitin 2019, në një rast tjetër ndryshimi kadastral është bërë për shkak të parcializimit por sipërfaqja ka mbetur e njëjtë dhe në tre rastet e fundit parcela është ndarë në tre njësi të cilat kanë mbetur të njëjta në sipërfaqe por të cilat kanë kaluar në pronësi të Kuvendit Komunal Pejë me vendim të vitit 1962.                                                                         |
| Prishtinë | Nga analiza e nëntë mostrave kemi identifikuar se një ndryshim kadastral është bërë me vendim të Qeverisë ku një pronë është dhënë tek Korporata Energjetike e Kosovës pastaj kjo pronë ka kaluar tek Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike në Kosovë SH.A (KEDS) për qira mbajtje 99 vite. Në gjashtë mostrat e tjera ndryshimet kadastrale kanë ndodhur vetëm për parcializim të tyre por sipërfaqja dhe pronari kanë mbetur të njëjtë. Në një mostër ndryshimet kadastrale janë bërë për shkak se një pjesë e parcelës ka kaluar tek personi privat me vendim të gjykatës të viti 2014 dhe mostra tjetër është bërë për shkak të shitblerjes së kësaj prone nga ana e AKP-së tek operator privat për 99 vite. |
| Prizren   | Nga analiza e mostrave kemi identifikuar se nga 17 mostra të analizuara, 15 kanë pasur ndryshime kadastrale ku disa nën ndarje të parcelave të tyre janë bartur në pronësi të Qeverisë së Kosovës, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur në pronësi të shtetit apo institucioneve të ndryshme publike. Dy mostra të tjera janë ndryshuar me vendim të Drejtorisë së Urbanizmit për planin rregullues "Dardania 2" por kanë mbetur prapë pronë shtetërore.                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

Nga analiza e mostrave kemi gjetur se shumica e parcelave kanë pësuar ndryshime kadastrale me vendime të Qeverisë së Kosovës, një pjesë e tyre janë shitur përmes procesit të privatizimit, disa për shkak të aktvendimeve të gjykatave të cilat datojnë nga periudha para vitit 2000 dhe raste tjera me vendim nga kuvendet komunale të komunave përkatëse për bartjen e pronës publike si pronë komunale.

### 3.3 Mungesa e inventarizimit të pyjeve në vend

*Agjencia Pyjore duhet të kryejë inventarizimet e pyjeve publike dhe do të grumbullojë të dhëna të mjaftueshme mbi pyjet që të mundësojë planifikim racional menaxhues. Inventarizimi Kombëtar i pyjeve dhe tokave pyjore bëhet në çdo 10 vjet dhe përdoret për nevoja të planifikimit strategjik dhe hartimit të politikave sektoriale.*

Agjencia Pyjore ka kryer dy inventarizime kombëtare të pyjeve, inventarizimi i parë është kryer në vitin 2002, ndërsa i dyti në vitin 2012. Sipas standardeve evropiane ky proces duhet të bëhet çdo dhjetë vite. Inventarizimi i radhës në vitin 2022 ende nuk është kryer. Andaj Agjencia Pyjore aktivitetet e saj i zhvillon pa inventarizim të pyjeve. Procesi i inventarizimit është shumë i rëndësishëm sepse ofron një pasqyrë të qartë të pyjeve në vend, që i ndihmon Agjencisë Pyjore zhvillimin e planeve menaxhuese dhjetë vjeçare mbi baza të qëndrueshme. Mungesa e inventarizimit i pamundëson MBPZHR-së të zhvillojë politika që pasqyrojnë realisht gjendjen në terren dhe të jenë në përputhje me nevojat aktuale të sektorit.

Agjencia Pyjore ende nuk e zhvillon në mënyrë të pavarur procesin e inventarizimit. Sipas Agjencisë pyjore për të kryer këtë projekt madhor ka mungesë të stafit profesional, përkundër faktit se stafi i Agjencisë ka marrë pjesë në inventarizimet e mëhershme si në vitin 2012. Ndërkohë që nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet për të arritur këtë objektivë.

Të dy inventarizimet Kombëtare të pyjeve janë financuar nga Qeveria Norvegjeze dhe janë implementuar përmes projektit ndërkombëtar të Norwegian Forest Group (NFG). Sipas Agjencisë pyjore në vitin 2020, Ogranizata Norwegian Forest Group (NFG) kishte shprehur vullnet për vazhdimin të bashkëpunimit për zhvillim të projektit të inventarizimit, por kanë kërkuar të dërgohet një kërkesë zyrtare nga ana e Ministrit tek kjo organizatë. Sipas Agjencisë një kërkesë e tillë nuk është dërguar tek NFG-ja.

Projekti i inventarizimit pritet të implementohet brenda këtij viti. Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian dhe Suedia, dhe pritet të zbatohet nga Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara-FAO.

Mungesa e një inventarizimi kombëtar të pyjeve ka efekte negative të mëdha në mjedis, ekonomi dhe shoqëri, duke penguar hartimin e planeve të sakta dhjetë vjeçare në bazë të të cilave caktohen planet operative vjetore të punës. Mungesa e informacioneve të tilla ndikon në mos planifikim të qëndrueshme të pyjeve si pyllëzimet dhe ripërtëritja e pyjeve, si dhe plane jo të qëndrueshme për përdorim të resurseve natyrore.

#### 3.3.1 Mungesa e Planeve Menaxhuese 10 vjeçare të Pyjeve

*Plani i menaxhimit të pyjeve është dokument afatgjatë planifikues i cili hartohet për dhjetë (10) vite, për njësinë menaxhuese, sipas metodologjisë unike, në bazë të inventarizimit në terren të grumbujve pyjorë dhe sipërfaqeve të tjera të përfshira në njësinë menaxhuese.<sup>32</sup>*

Hapësirat pyjore në vend përbëhen nga 76 njësi pyjore për të cilat duhet hartohen planet menaxhuese 10 vjeçare. Prej tyre, 25 njësi pyjore ju kanë skaduar planet menaxhuese madje tri prej tyre nuk kanë pasur asnjëherë plan menaxhues, ndërsa gjashtë plane menaxhuese skadojnë këtë vit, që arrijnë totalin prej 31 plane menaxhuese jo aktive deri në fund të vitit

<sup>32</sup> Ligji Nr.08/L-137 për pyjet, neni 26

2025. Sipas Agjencisë Pyjore disa nga njësitë pyjore që nuk kanë plane menaxhuese janë kryesisht pyje të ulëta ose të degraduara dhe me më pak prioritet, ku aktivitetet ekonomike, si shfrytëzimi i drurit ose rehabilitimi janë të kufizuara.

Tri njësi menaxhuese në komunën e Mitrovicës nuk kanë pasur asnjëherë plane menaxhuese që nga viti 2000. Mungesa e këtyre tri planeve menaxhuese sipas Agjencisë Pyjore lidhet edhe me faktorë të situatës politike dhe me mungesën e të dhënave të plota mbi gjendjen e pyjeve. Sipas Agjencisë Pyjore mos mbulimi i të gjitha njësive pyjore me plane menaxhuese ndodh për shkak të buxhetit të limituar, ndërsa në mungesë të këtyre planeve Agjencia Pyjore zhvillon aktivitete në pyje bazuar në vlerësimi profesional sipas prioriteteve.

Mungesa e planeve menaxhuese paraqet rrezik që një pjesë e madhe e pyjeve në vend të mbetet pa trajtim adekuat, pasi zhvillimi i aktiviteteve nuk bazohet në nevojat reale të menaxhimit të pyjeve në atë zonë.

### 3.3.2 Mos arritja e objektivave të planeve vjetore

Agjencia Pyjore në bashkëpunim me njësit e veta duhet të miratojë planin vjetor operacional të menaxhimit për secilin grumbull pyjor të pyjeve publike nën administrim të saj, Planet e menaxhimit operacional përshkruajnë aktivitetet e përmirësimit të pyjeve dhe aktivitetet e prerjes.<sup>33</sup>

Agjencia Pyjore rreth 44% të planeve vjetore të përcaktuara në plan menaxhues vjetor nuk arrin t'i realizoj. Planet menaxhuese vjetore përgatiten duke u bazuar në planet 10 vjeçare në bazë të të cilave identifikohen fushat me më shumë prioritet.

Përveç vitit 2023, ku Agjencia Pyjore ka arritur të realizoj objektivën për kultivim dhe përtëritje të pyjeve, në fushat tjera në përgjithësi ka ngecje të mëdha.

Në tabelën në vijim kemi paraqitur nivelin e realizimit të objektivave të parapara në plane vjetore për secilën kategori të planifikuar. Niveli i realizimit është vlerësuar në fushat si: kultivimi i pyjeve, trajtimi i pyjeve, ngritja e pyjeve të reja, pastrimi i rrugëve dhe shtigjeve, Planifikimi dhe shfrytëzimi në pyje shtetërore, Planifikimi dhe realizimi në pyje private, shfrytëzimi i pyjeve me tenderim dhe shfrytëzimi për nevoja familjare.

Tabela 8. Niveli i realizimit të objektivave të planeve vjetore për vitet 2020-2024 në ha.

| Viti | Objektivat e planifikuar                                         | Vlera Planifikuar (ha) <sup>e</sup> | Vlera Realizuar (ha) <sup>e</sup> | Realizimi (%) |
|------|------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------------|---------------|
| 2024 | Kultivimi dhe përtëritja e pyjeve                                | 1410                                | 325                               | 23%           |
|      | Trajtimi i pyjeve                                                | 5409                                | 757                               | 14%           |
|      | Ngritja e pyjeve të reja                                         | 105                                 | 0                                 | 0%            |
|      | Pastrimi i rrugëve dhe shtigjeve                                 | 5                                   | 0                                 | 0%            |
|      | Planifikimi dhe shfrytëzimi në pyje shtetërore (m <sup>3</sup> ) | 60,814                              | 18,599                            | 31%           |
|      | Planifikimi dhe realizimi në pyje private (m <sup>3</sup> )      | 168,130                             | 110,760                           | 66%           |
| 2023 | Kultivimi dhe përtëritja e pyjeve                                | 1591                                | 1624                              | 102%          |
|      | Trajtimi i pyjeve                                                | 5858                                | 1034                              | 18%           |
|      | Ngritja e pyjeve të reja                                         | 372                                 | 95                                | 26%           |

<sup>33</sup> Ligji nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, neni 18

|      |                                                                  |         |         |      |
|------|------------------------------------------------------------------|---------|---------|------|
|      | Planifikimi dhe shfrytëzimi në pyje shtetërore (m <sup>3</sup> ) | 79,860  | 21,967  | 26%  |
|      | Planifikimi dhe realizimi në pyjet private (m <sup>3</sup> )     | 192,000 | 107,223 | 56%  |
| 2022 | Kultivimi dhe përtëritja e pyjeve                                | 1605    | 18      | 1%   |
|      | Trajtimi i pyjeve                                                | 4682    | 312     | 7%   |
|      | Ngritja e pyjeve të reja                                         | 304     | 122     | 40%  |
|      | Planifikimi dhe shfrytëzimi në pyje shtetërore (m <sup>3</sup> ) | 56,654  | 22,121  | 39%  |
|      | Planifikimi dhe realizimi në pyje private (m <sup>3</sup> )      | 178,000 | 149,121 | 84 % |
| 2021 | Kultivimi dhe përtëritja e pyjeve                                | 8479    | 172     | 2%   |
|      | Planifikimi dhe shfrytëzimi në pyje shtetërore (m <sup>3</sup> ) | 67,972  | 27,221  | 40%  |
|      | Planifikimi dhe realizimi në pyje private (m <sup>3</sup> )      | 192,290 | 164,202 | 85%  |
|      | Trajtimi i Pyjeve                                                | 563     | 307     | 55%  |
| 2020 | Kultivimi dhe përtëritja e pyjeve                                | 7146    | 142     | 2%   |
|      | Planifikimi dhe shfrytëzimi në pyje shtetërore (m <sup>3</sup> ) | 67,514  | 26,229  | 39%  |
|      | Trajtimi i Pyjeve                                                | 458     | 381     | 83%  |
|      | Planifikimi dhe realizimi në pyje private (m <sup>3</sup> )      | 200,180 | 158,198 | 79%  |

Aktivitetet për pyllëzim realizohen përmes procesit të tenderimit nga Agjencia Pyjore. Shkalla e ulët e aktiviteteve të realizuara të pyllëzimeve lidhen me kufizimet buxhetore si dhe nivelin e ulët të interesimit nga ana e operatorëve ekonomik për pjesëmarrje në tender. Edhe tek proceset e ankandëve ka pasur interesim të ulët të të interesuarve për blerje të masës drusore, për shkak të orientimit të qytetarëve drejt alternativave tjera për ngrohje, përmirësimi i izolimit të objekteve dhe orientimi për furnizim më lëndë të parë nga importet.

Edhe pse realizohen këto pyllëzime sipas Agjencisë Pyjore dhe vlerësimit të raporteve të monitorimit të këtyre hapësirave të mbjella shihet se një pjesë e madhe e pyllëzimeve të reja dështojnë. Sipas inspektorëve faktorët kryesor të dështimit të pyllëzimit të këtyre hapësirave janë mungesa e monitorimit të kompanisë e cila duhet të bëjë mirëmbajtjen gjatë periudhës së obliguar nga ana e Agjencisë Pyjore, por edhe dëmtimet nga kafshët e egra. Ndërsa sipas Agjencisë Pyjore kjo ndodh për shkaqe të kushteve klimatike, siç është nxehtësia e madhe.

Në anën tjetër Instituti Pyjor i Kosovës në kuadër të MBPZHR përveç analizave dhe punëve profesionale në pyje ka edhe fidanishten në të cilën kultivon fidanë, me të cilat e furnizon kompaninë e kontraktuar për pyllëzim.

Sipas të dhënave të Instituti Pyjor të Kosovës dhe vizitës tek kjo fidanishte aktualisht janë në pritje për mbjellje rreth një milion fidanë, mosha e tyre është nga dy deri në 11 vjeçare.



Foto 3. Kultivimi i fidanëve nga Instituti Pyjor i Kosovës.



Sipas ekspertizës së Instituti Pyjor të Kosovës përqindja e zënies së fidanëve mbi moshën dy vjeçare është në nivel të ulët dhe rrezikojnë të dështojnë.

Mos realizimi i objektivave vjetore të Agjencisë Pyjore ka pasoja serioze për mjedisin, ekonominë dhe cilësinë e jetës në vend. Dështimi në kultivimin dhe përtëritjen e pyjeve dobëson kapacitetin e pyjeve për të rigjeneruar veten, duke rritur rrezikun e degradimit të tokës, erozionit dhe humbjes së biodiversitetit. Po ashtu, humbje financiare të buxhetit të vendit, për shkak të kostos së kultivimit të fidanëve nga fidanishtja. Ndërsa mos ngritja e pyjeve të reja përfaqëson një stagnim në zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra, që janë jetike për balancimin e emetimeve të karbonit dhe për përballimin e ndryshimeve klimatike.

Agjencia Pyjore nuk ka arritur të realizoj aktivitetet e pastrimit të rrugëve dhe shtigjeve gjë që pengon qasjen në zona pyjore, duke ndikuar negativisht në menaxhimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore. Këto dështime përkeqësojnë shërbimet që pyjet ofrojnë për shoqërinë dhe ekonominë, si dhe dobësojnë përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm.

### 3.3.3 Mangësi në procesin e dhënies së pronave me qira

*Procesi i dhënies së tokave me qira ku pronar/titullar është shteti duhet të jetë transparent dhe i hapur në mënyrë që të sigurojë llogaridhënien, mundësitë e barabarta për investitorët, po ashtu qeverisje të mirë dhe përdorim efikas të tokës.<sup>34</sup>*

Agjencia Pyjore nuk ka zhvilluar proces transparent të qiradhënies së hapësirave pyjore, procedurat e qiradhënies janë zhvilluar pa thirrje publike ndërsa kërkesat e pranuar për qira janë trajtuar individualisht në mënyrë të veçantë pa proces të unifikuar.

Agjencia Pyjore në vazhdimësi ka lidhur kontrata të qiradhënies për shfrytëzim të hapësirave pyjore për aktivitete të gurthyesve dhe për shfrytëzim të hapësirave pyjore për aktivitete tjera siç janë: kullosë, mbjelljen e kulturave pemë drufrutore, vendosje të turbinave për energji elektrike, ngritje të objekteve të përkohshme, aktivitete afariste hotelierie etj. Për analizimin e procesit të dhënies me qira të hapësirave pyjore kemi përzgjedhur 35 mostra.

<sup>34</sup> Kriter i përcaktuar nga auditorët bazuar në gjykimin profesional



Sipas rregullores duhet të formohet komisioni prej pesë anëtareve për vlerësimin e kërkesave për qiradhënie. Mirëpo vlerësimin e kërkesave e kanë bërë vetëm tre anëtar dhe jo pesë sipas kërkesës së rregullores. Mungesa e pjesëmarrjes së plotë të anëtarëve në këtë komision rrezikon transparencën dhe legjitimitetin e procesit. Kjo përbën shkelje të udhëzimeve dhe krijon hapësirë për vendimmarrje jo meritore apo të njëanshme.

Agjencia Pyjore nuk ka pasur afat të caktuar të trajtimit të kërkesave për qiradhënie. Nga mostrat të përzgjedhura, 16 prej tyre kanë pasur vonesa të mëdha në trajtimin e tyre, nga gjashtë deri në 38 muaj.

Rastet e vonesave të pa arsyeshme të trajtimit të kërkesave për qiradhënie nga mostrat e përzgjedhura janë paraqitur më poshtë:

Tabela 9. Vonesat në trajtimin e kërkesave për qiradhënie

| Kërkesa      | Pëlqimi      | Kontrata     | Vonesa në muajt |
|--------------|--------------|--------------|-----------------|
| Janar 2021   | Nëntor 2023  | Mars 2024    | 38              |
| Maj 2023     | Shtator 2023 | Shtator 2023 | 6               |
| Mars 2023    | Shtator 2023 | Mars 2024    | 12              |
| Shtator 2021 | Shtator 2023 | Maj 2024     | 32              |
| Tetor 2022   | Tetor 2023   | Tetor 2023   | 12              |
| Shtator 2022 | Shkurt 2023  | Maj 2023     | 8               |
| Qershor 2019 | Nëntor 2019  | Janar 2021   | 19              |
| Shtator 2020 | Nëntor 2021  | Shkurt 2022  | 17              |
| Shkurt 2020  | Nëntor 2021  | Prill 2022   | 26              |
| Tetor 2019   | Maj 2020     | Maj 2020     | 7               |
| Mars 2019    | Qershor 2019 | Gusht 2020   | 16              |
| Nëntor 2021  | Korrik 2022  | Gusht 2022   | 8               |
| Dhjetor 2018 | Janar 2019   | Shtator 2020 | 22              |
| Shkurt 2020  | Korrik 2020  | Shtator 2022 | 31              |
| Maj 2023     | Nëntor 2023  | Mars 2024    | 10              |
| Nëntor 2022  | Mars 2023    | Prill 2023   | 6               |

Sipas Agjencisë Pyjore, vonesa nga pëlqimi deri te nënshkrimi i kontratës mund të ndodhë në rastet kur palët ende nuk e kanë sjellë licencën nga KPMM apo ndonjë dokument nga ana e komunës përkatëse, siç janë lejet e ndërtimit.

Agjencia nuk ka qenë efektive në menaxhimin e procesit të qiradhënies së hapësirave pyjore, duke reflektuar mangësi të konsiderueshme në të gjitha fazat e këtij procesi. Mungesa e standardeve të qarta procedurale ndikon në uljen e besueshmërisë së palëve të interesuara, parimin e barazisë etj. Kjo qasje jo vetëm që krijon pasiguri tek palët e interesuara, por ndikon drejtpërdrejt edhe në aspektin e tyre ekonomik, duke i penguar në planifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve afariste.

Ndërsa palët që kanë kërkuar vazhdimin e kontratave, në një mënyrë apo tjetër, kanë vazhduar të shfrytëzojnë hapësirat pyjore, por pa kontratë.

Nga vlerësimi i mostrave të kontratave të qiradhënies tek guroret shihet se në dy kontrata palët gjatë shprehjes së kërkesës për qiramarrje kanë sjellë dëshmi planet zhvillimore

komunale për parcelat për të cilat kanë shprehur interesim, por që aktiviteti i prezantuar në plan zhvillimor komunal nuk ka qenë në harmoni me natyrën e kontratës, siç janë:

- Në kontratën me nr. KE-409/24, qiramarrësi ka të dorëzuar planin zhvillimor komunal sipas të cilit një pjesë nga parcela për të cilën është shprehur kërkesa është bujqësore ndërsa pjesa tjetër industriale, ndërsa Agjencia Pyjore ka dhënë në shfrytëzim këtë hapësirë për aktivitete te guroreve.
- Në kontratën me nr. KE-262/23, qiramarrësi ka të dorëzuar planin zhvillimor komunal sipas të cilit kjo zonë është e mbrojtur me shfrytëzim bujqësor, të kullosave dhe aktiviteteve të turizmit malor, ndërsa kontraktuesi e shfrytëzon atë hapësirë për aktivitete te guroreve.

Raste tjera të shkeljeve gjatë lidhjes së kontratave ka qenë edhe dhënia me qira e hapësirave pyjore për pronat që nuk janë nën menaxhimin e saj. Në dy kontrata të qiradhënies pasi që operatorët kanë filluar aktivitetin, Agjencia Pyjore u ka ndërprerë kontratat me arsyetimin se ka konteste pronësore, madje në njërin nga rastet ka lidhur kontratë për ushtrimin e aktivitetit në zonën e mbrojtur ujore që nuk lejohet sipas MMPHI-së.

Po ashtu Agjencia Pyjore ka hartuar kontrata me kushte të ndryshme për qiramarrës të ndryshëm për aktivitete të njëjta. Mos hartimi i njëjtë i kontratës për kontraktues të ndryshëm tregon jo profesionalizëm dhe krijon mundësi për trajtim të pabarabartë të kushteve të kontratës për qiramarrës të ndryshëm, gjë që mund të ketë pasoja edhe gjatë zbatimit të kontratave.

Agjencia Pyjore nuk ka qenë efektive në shqyrtimin me kohë të aplikacioneve të qiramarrësve ekzistues për vazhdimin e shfrytëzimit të hapësirave pyjore me kontrata të reja. Si rezultat, edhe pas skadimit të kontratave ekzistuese, qiramarrësit kanë vazhduar të shfrytëzojnë hapësirat për disa vite, deri kur aplikacionet e tyre janë shqyrtuar dhe janë lidhur kontrata të reja me efekt retroaktiv. Në këto raste, pagesa për shfrytëzimin është bërë për periudhën që nga data e skadimit të kontratës së mëparshme, duke mbuluar në mënyrë pasuese përdorimin e hapësirës gjatë gjithë kohës ndërmjet dy kontratave.

Në tabelën në vijim do të paraqesim rastet e tilla.

*Tabela 10. Hyrja në fuqi e kontratave në mënyrë retroaktive*

| Nr. Kontratës | Hyrja në fuqi e kontratës në mënyrë retroaktive | Nr. Kontratës | Hyrja në fuqi e kontratës në mënyrë retroaktive |
|---------------|-------------------------------------------------|---------------|-------------------------------------------------|
| Kontrata 1    | 10 muaj                                         | Kontrata 9    | 1 vit e 1 muaj                                  |
| Kontrata 2    | 11 muaj                                         | Kontrata 10   | 10 muaj                                         |
| Kontrata 3    | 1 muaj                                          | Kontrata 11   | 3 muaj                                          |
| Kontrata 4    | 2 vite e 7 muaj                                 | Kontrata 12   | 2 muaj                                          |
| Kontrata 5    | 3 muaj                                          | Kontrata 13   | 1 vit e 10 muaj                                 |
| Kontrata 6    | 7 muaj                                          | Kontrata 14   | 2 muaj                                          |
| Kontrata 7    | 2 vite e 2 muaj                                 | Kontrata 15   | 10 ditë                                         |
| Kontrata 8    | 7 muaj                                          | Kontrata 16   | 1 vit e 9 muaj                                  |

Siç shihet në tabelën më lartë hyrja në fuqi në mënyrë retroaktive ka ndodhur në 16 nga 35 mostrat e zgjedhura, ku devijimi mes ditës së nënshkrimit dhe datës së hyrjes në fuqi në mënyrë retroaktive ka shkuar deri në 2 vite e 7 muaj.

Sipas Agjencisë Pyjore, hyrja në fuqi në mënyrë retroaktive ka për qëllim mbledhjen e pagesave gjatë kohës sa hapësirat janë shfrytëzuar pa kontratë. Megjithatë, kjo tregon një nivel jo të duhur të përgjegjshmërisë në trajtimin e kërkesave me kohë, edhe pse qiramarrësit kishin aplikuar në kohë për vazhdim të kontratës para skadimit të saj.

Kjo praktikë po ashtu krijon një periudhë retroaktive të pa dokumentuar ligjërisht, ku nuk ka pasur kontratë të vlefshme në fuqi, por me supozim në marrëdhënie kontraktore.

Dhënia e pronave publike me qira është pezulluar pas hyrjes në fuqi të Ligjit Për Pronën Publike. Sipas këtij ligji Njësia për Administrimin e Pronës Publike ka kompetencë për dhënien e pëlqimit për qiradhënie. Vonesa e funksionalizimit të Njesisë për Administrimin e pronës publike ka shkaktuar mos trajtimin e kërkesave të reja për qiradhënie dhe mos vazhdimin e kontratave të skaduara të qiradhënies. Si rezultat, operatorët vazhdojnë të përdorin hapësirat pa kontrata të vlefshme. Gjatë auditimit kemi hasur edhe në 44 kontrata të nënshkruara pas hyrjes në fuqi të ligjit për pronën publike, sipas të cilit Agjencia Pyjore nuk ka pasur kompetenca për nënshkrimin e kontratave.

### 3.3.4 Mungesa e mbikëqyrjes së kontratave të qiradhënies

*Agjencia Pyjore duhet të bëjë mbikëqyrjen e kontratave për qiradhënie në baza vjetore përmes komisionit mbikëqyrës në koordinim me drejtoritë menaxhuese regjionale, ndërsa MBPZHR-ja të bëjë monitorimin e rregullt të kontratave për qiradhënie të pyjeve apo tokave pyjore çdo tre muaj nga Komisioni.<sup>35</sup>*

Drejtoritë regjionale të Agjencisë Pyjore, nuk i kanë monitoruar rregullisht kontratat për qiradhënie gjatë kohës sa kanë qenë aktive, mirëpo as nuk kanë mbikëqyrur përfundimin e kontratës dhe kthimin e hapësirës së marrë me qira në gjendjen e mëparshme. Agjencia Pyjore nuk ushtron kontroll të rregullt të Drejtorive regjionale të cilat kanë për obligim të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme kontratat për qiradhënie.

Nga vlerësimi i raporteve të monitorimit për vitet 2020-2024 të kontratave të qiradhënies të drejtorive regjionale, shihet se ka shumë mangësi dhe se ato nuk janë monitoruar në baza të rregullta vjetore.

- Drejtoria koordinuese e Gjilanit nuk ka dorëzuar raporte të monitorimit për vitet 2020, 2022, 2023.
- Drejtoria koordinuese e Mitrovicës nuk ka dorëzuar raporte të monitorimit për vitet 2021, 2022, të kontratave që kanë qenë aktive atë kohë.
- Drejtoria koordinuese e Pejës nuk ka dorëzuar raporte të monitorimit për vitet 2022, 2023 dhe 2024.
- Drejtoria koordinuese e Prizrenit ka dorëzuar raportet vetëm për vitin 2023, ndërsa për vitet tjera nuk ka dorëzuar raporte të monitorimit.
- Drejtoria koordinuese e Ferizajit ka dorëzuar një përmbledhje të kontratave të qiradhënies të zonës së saj, me përshkrim të shtrirjes së tyre dhe foto të parcelave, mirëpo pa ndonjë raport të monitorimit të respektimit të kushteve të kontratës për secilën prej tyre.

<sup>35</sup> Udhëzimit administrativ (MBPZHR)nr. 01/2020 për plotësimin e UA 01/2006 për ndërrimin e destinimit të përkohshëm të tokës pyjore.

Në mostrat e përzgjedhura kemi vërejtur një rast kur komisioni i monitorimit ka ndërhyrë në shpëputjen e kontratës pasi është evidentuar se pala nuk ka respektuar kushtet e kontratës për shfrytëzim të hapësirës pyjore me qëllimin për të cilin e ka marrë për kullosë, por ka ndërtuar objekt me mure dhe blloqe betoni.

Por jo në çdo rast Agjencia Pyjore ka bërë monitorimin e rregullt dhe rrjedhimisht evidentimin e shkeljeve eventuale. Pas analizimit të raporteve të inspektimeve, kemi hasur në disa raste ku vetëm pas intervenimit me anë të inspektoratit, Agjencia Pyjore ka shpëputur kontratën me palën që ka shfrytëzuar kontratën jashtë kushteve të saj.

Raportet e inspektoratit të pylltarisë tregojnë një nivel jo të duhur të monitorimit të kontratave nga ana e drejtorive koordinuese regjionale, si në rastin në vijim i raportuar nga inspektorati.

Foto 4. Ndërtimi të forta në kontratën për qiradhënie (foto inspektorati)



Inspektorët e regionit të Prishtinës kanë evidentuar se në hapësirën pyjore të dhënë për shfrytëzim të përkohshëm për ngritjen e një objekti hotelieri, është ndërtuar objekt me materiale të forta, duke tejkaluar kushtet e kontratës. Kontrata për shfrytëzimin e kësaj hapësire ishte në fuqi nga viti 2017 deri në vitin 2022, ndërsa Agjencia Pyjore nuk ka ofruar raport monitorimi për përfundim të saj. Por shfrytëzimi i hapësirës ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023, kur edhe janë evidentuar

shkeljet nga ana e inspektorit dhe ngritja e padis nga ana e Agjencisë Pyjore.

Mos monitorimi i shfrytëzimi i hapësirave pyjore sipas kushteve të kontratës dhe ndërtime të forta në zona pyjore shkakton dëmtimin e pyjeve, ndërrim të destinimit dhe dëmtim të cilësisë së tokës.

### 3.3.5 Mungesa e ri-kultivimit të zonave pas shfrytëzimit

*Krahas kërkesës për dhënie të lejes për ndërtime për shfrytëzim të përkohshëm të tokës bujqësore/pyjore për destinime të tjera si dhe për ndërtimin e përkohshëm nga e cila vjen deri te dëmtimi përreth i tokës bujqësore, shfrytëzuesi është i detyruar ta paraqet projektin për ri kultivim i cili bëhet në pajtim me dokumentacionin teknik për ndërtim.<sup>36</sup>*

Sipas kontratës së qiradhënies, operatorët ekonomik kanë për obligim që hapësirën të cilën e marrin me qira, pas përfundimit të aktivitetit të tyre ta kthejnë në gjendjen fillestare. Ndërsa sa i përket gurave ato e kanë për obligim që pjesën e shfrytëzuar të ri-kultivojnë, që nënkupton nivelimin e terrenit, mbulimin me shtresa toke pjellore, mbjelljen e bimësisë (përgjithësisht barëra, drunë ose shkurre), dhe në disa raste, shndërrimin e zonës për përdorime të tjera si bujqësi, kullosë etj. Procesin e ri-kultivimit qiramarrësit duhet ta kryejnë minimum tre muaj para përfundimit të licencës duke u bazuar në "Planin e Ri-kultivimit" të përpiluar nga Instituti i Pyjor i Kosovës të cilin e dorëzojnë në momentin e aplikimit.

<sup>36</sup> Ligji 02/L-26 për tokën bujqësore, neni 17



Procesi i ri-kultivimit vlerësohet nga një komision ndërinstitucional në mes të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), AKP-së dhe MMPHI-së. Komisioni përbëhet nga pesë anëtar, ku dy janë nga KPM, dy nga AKP-ja dhe një nga MMPHI.

Nga analiza e të gjitha rasteve të kërkesave për ri kultivim gjatë viteve 2015-2024 kemi gjetur se nga 19 kërkesa të tilla, tri raste nuk i është aprovuar ri kultivimi nga Komisioni ndërmintor, për arsye se qiramarrësit nuk kishin kryer ri kultivimin sipas planit. Këto raste janë përcjellë me padi në gjykatë. Tre operator kishin aplikuar për vazhdim të kontratës së qiramarrjes, ndërsa 13 operator tjerë kishin ri-kultivuar zonat sipas planit.

Shkak i mos ri-kultivimit të zonave është papërgjegjshmëria e qiramarrëseve të cilët tentojnë ti ikin përgjegjësisë së tyre dhe vonesat e trajtimit në gjykata të këtyre proceseve etj.

Më poshtë kemi paraqitur dy raste përmes fotove nga zonat pyjore para shfrytëzimit të hapësirës pyjore, gjatë shfrytëzimit dhe pas përfundimit të aktivitetit.

Rasti i parë: Foto 5. Hapësira pyjore para shfrytëzimit



Foto 6. Hapësira pyjore gjatë shfrytëzimit



Rasti i dytë: Foto 7. Hapësira pyjore pas shfrytëzimit (mos ri kultivim)



Ndërsa në vijim kemi paraqitur foto të një hapësire tjetër pyjore të cilën i njëjti operator e ka shfrytëzuar dhe pas përfundimit të aktivitetit nuk e ka kryer ri-kultivimin.



Foto 8. Hapësira pyjore para shfrytëzimit




Foto 9. Hapësira pyjore pas shfrytëzimit



Mos ri-kultivimi i tyre sipas planit paraqet rrezik për gjallesat e asaj zone, por ka pasojë edhe në humbjen e masës drusore të asaj sipërfaqe.

## 4 Konkluzionet

Menaxhimi i hapësirave pyjore në vend po përballet me sfida të shumta, të ndërlidhura me ndryshimet ligjore e rregullative, koordinimin e riorganizimit të trupave përgjegjëse dhe procesin në vijim të regjistrimit të gjendjes në terren. Këto zhvillime kanë nxjerrë në pah dobësitë gjatë menaxhimit të kësaj fushe dhe tregojnë se ende ka shumë për të bërë për të siguruar mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve në vend.

Menaxhimi dhe dhënia me qira e hapësirave pyjore nga Agjencia Pyjore dhe institucionet përkatëse janë karakterizuar me mungesë transparence, koordinimi, dhe përgjegjësisë institucionale. Mungesa e një liste dhe regjistri të unifikuar të pronave pyjore të cilat menaxhohen nga Agjencia Pyjore ndikon në shfrytëzime të paautorizuara dhe raste të uzurpimit të vazhdueshme të hapësirave pyjore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka arritur të krijojë një kornizë të plotë rregullative funksionale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Mungesa e udhëzimeve administrative për zbatimin e Ligjit të ri për Pyjet ka bërë që Agjencia Pyjore të funksionoj pa Udhëzues Administrativ, duke lënë të pambuluara fusha të rëndësishme si: inventarizimi i pyjeve, ri kultivimi dhe mbrojtja nga zjarret.

Agjencia Pyjore nuk ka informacion të plotë për pronat nën menaxhimin e saj. Rreth 500 prona kadastrale figurojnë me emërtime të ndryshme dhe të pa unifikuara, gjë që e vështirëson planifikimin dhe mbikëqyrjen efektive të territorit pyjor. Mungesa e inventarizimit kombëtar të pyjeve në Kosovë që nga viti 2022, ka pamundësuar hartimin e politikave të bazuara në të dhëna reale dhe planifikimin strategjik të qëndrueshëm.

Inspektorati i Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka arritur të realizoj planin e tij vjetor për inspektime në funksion të mbrojtjes së pyjeve. Organizimi i brendshëm dhe pamundësia për të ndjekur prioritetet sipas rrezikut kanë penguar realizimin efektiv të detyrave të inspektimit.

MBPZHR nuk ka arritur të ushtroj mbikëqyr dhe monitoroj Agjencinë Pyjore si dhe të siguroj funksionim të duhur të inspektoratit pyjor dhe të mbikëqyr punën e tij, duke rezultuar me dëmtim të hapësirave pyjore.

Nuk ka një proces të standardizuar dhe transparent për dhënien me qira të hapësirave pyjore nga Agjencia Pyjore. Procesi i qiradhënies është përcjellë me shkelje të procedurave si: komisione jo të plotë për vlerësimin e kërkesave, mungesë të monitorimit. Për më tepër, mungesa e koordinimit ndërinstitutional për trajtimin e sëmundjeve të pyjeve dhe dëmtimeve të shkaktuara nga insektet ka rezultuar në humbje të konsiderueshme të masës drusore, sidomos në zonat e mbrojtura të parqeve kombëtare, ku ndërhyrjet janë të kufizuara nga legjislacioni aktual.

## 5 Rekomandimet

Për të përmirësuar menaxhimin e pyjeve dhe siguruar zbatimin e politikave të qëndrueshme, rekomandohet që Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencia Pyjore e Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit të ndërmarrin masat të cilat janë nën përgjegjësinë e tyre për ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve në vend, rekomandojmë:

1. Qeveria e Kosovës të funksionalizoj Njësinë për Administrimin e Pronës Publike për të adresuar çështjet rregullative dhe funksionale për pronat publike pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pronën Publike.
2. MBPZHR dhe Agjencia e Pyjeve të sigurojnë proces efikas të hartimit dhe miratimit të udhëzuesve përkatës për menaxhimin sa më efektiv të hapësirave pyjore në vend.
3. MBPZHR të realizoj inventarizimin kombëtar të pyjeve duke angazhuar edhe kapacitetet e saj profesionale, dhe të siguroj hartimin e planeve menaxhuese dhjetëvjeçare për të gjitha njësitë pyjore.
4. MBPZHR të krijoj bashkëpunim adekuat ndërmjet Departamentit të Pylltarisë dhe Inspektoratit të Pylltarisë, për të siguruar shkëmbimin e informacionit të nevojshëm dhe të koordinohen me qëllim të zhvillimit të politikave të duhura për pyje.
5. MBPZHR të siguroj bazë të qartë ligjore dhe rregullative për funksionimin e Inspektoratit të Pyjeve dhe të siguroj mbikëqyrje efektive mbi të, për të garantuar zbatimin e përgjegjësisë ligjore dhe raportim të rregullt mbi zbatimin e ligjit dhe efektivitetin e veprimeve inspektuese.
6. Agjencia Pyjore të krijoj një regjistër të unifikuar të të gjitha pronave pyjore nën menaxhimin e saj. Ky regjistër duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe i azhurnuar duke mundësuar vendndodhjen e pronave dhe identifikimin e uzurpimeve të mundshme.
7. Agjencia Pyjore të siguroj monitorim efikas të drejtorive koordinuese regionale.
8. Agjencia Pyjore të siguroj arritjen e objektivave dhe të ndërmerr të gjitha masat që procesi i pyllëzimit të hapësirave pyjore të jetë efektiv në mënyrë që fidanët të cilat gjinden në Fidanishte të mbjellën në kohën e duhur.
9. Agjencia Pyjore duhet të fuqizoj sistemin e menaxhimit të mbrojtjes së pyjeve të rris dhe shfrytëzoj/përdor kapacitetet e sajë teknologjike në terrenet të cilat paraqesin rrezik më të lartë të dëmtimeve dhe prerjeve ilegale.
10. MMPHI dhe AMMK duhet të krijojnë mekanizëm funksional për menaxhimin efektiv të parqeve kombëtare, duke përmirësuar kuadrin rregullativ për ndërhyrje sanitare, rritur mbikëqyrjen në terren dhe zbatuar masat kundër prerjeve dhe ndërtimeve ilegale, me qëllim të ruajtjes së qëndrueshme të pyjeve dhe biodiversitetit.
11. MMPHI përkatësisht Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Agjencia Pyjore për të rrisin nivelin e bashkëpunimit për të përmirësuar menaxhimin e pyjeve dhe mbrojtjen e tyre nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Këto dy institucione duhet të analizojnë praktikën e mira ndërkombëtare dhe të marrin masa të shpejta dhe të koordinuara për eliminimin dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve në pyje.

## Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

### Motivi i auditimit

Edhe pse hapësirat pyjore të vendit përbëjnë një pasuri të konsiderueshme natyrore, institucionet e vendit në vazhdimësi kanë hasur sfida në ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre. Problemet e menaxhimit dhe mbrojtjes së pyjeve në Kosovë janë të shumta dhe të lidhura ngushtë me sfida të ndryshme që ndikojnë në shëndetin dhe qëndrueshmërinë e këtyre burimeve natyrore. Problemet kryesore lidhen me shpyllëzimin e pa ligjshëm dhe degradimin e pyjeve, të shkaktuara nga prerjet ilegale dhe shfrytëzimi i paqëndrueshëm i burimeve pyjore.

Sipas raportit të progresit për Kosovën për vitin 2024, prerja e paligjshme e pyjeve mbeten çështje shqetësuese. Kjo është vërejtur edhe nga analiza e raporteve të Agjencisë pyjore, ku janë identifikuar probleme në mbikëqyrjen e prerjeve të drurit dhe ndërrimit të destinimit të tokave pyjore për qëllime ndërtimi. Aktivitetet e paligjshme për ndërtimin e objekteve në këto zona pyjore, kanë kontribuar në prerjet ilegale të shpejtë dhe dëmtimin e ekosistemeve pyjore.

Shfrytëzimi i pyjeve nga komuniteti lokal për drutë e zjarrit dhe si lëndë e parë për zhvillimin e industrisë së drurit, apo aktivitete të tjera ekonomike ka pasur ndikim të madh në gjendjen e përgjithshme të pyjeve në vend. Mungesa e një programi gjithëpërfshirës për të angazhuar komunitetin lokal në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve ka krijuar vakume në ruajtjen e këtyre hapësirave. Nga analiza e të dhënave gjatë fazës para studimore, ka indikacione që ka ndodhur tjetërsime dhe shkëmbim i pronave publike pyjore, ky fenomen ka përfshirë kalimin e pronave publike pyjore tek komunat etj.<sup>37</sup>

Po ashtu sipas Agjencisë pyjore kompanitë të cilat shfrytëzojnë zonat pyjore për nxjerrjen e mineraleve gurore nuk arrijnë të bëjnë ri kultivimin e atyre zonave duke shkaktuar rrezik të përgjithshëm.

Përveç faktorët natyrorë dhe biotikë si zjarret pyjore, sëmundjet dhe insektet, ndikojnë në shëndetin e pyjeve, duke shkaktuar humbje të masës drunore dhe zvogëlim të produktivitetit të pyjeve. Për evitimin e një numrit të madh të problemeve me të cilat ballafaqohen institucionet përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve, sfidë mbetet mungesa e stafit profesional të kualifikuar, politika jo të duhura për menaxhimin e rojeve të pyjeve nga ana e APK -së dhe mos menaxhimi si duhet i kontratave të qiradhënies dhe procesit të ri kultivimit të hapësirave pyjore.

Mungesa e koordinimit në mes të institucioneve përgjegjëse si Agjencia Pyjore dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si institucione përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve brenda parqeve kombëtare të "Sharrit" dhe " Bjeshkëve të Nemuna" dhe mos harmonizimi i legjislacionit për menaxhimin e atyre pyjeve ka shkaktuar dëmtim dhe degradim të pyjeve në ato zona. Vetëm gjatë vitit 2022, për dëmet e shkaktuara në resurset natyrore, Drejtoritë e Parqeve Kombëtare Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna, kanë ngritur në prokuroritë themelore 66 kallëzime penale, të cilat sipas vlerësimeve të AMMK-së kanë dëmtuar resurset natyrore me rreth 80,594 euro.<sup>38</sup> Nga raporti i inventarizimit të vitit 2012, pyjet në këto dy parqe kombëtare përfshijnë pothuajse të gjitha pyjet e larta në territorin tonë. Ndërsa sipas vlerësimeve të Agjencisë Pyjore dëmet nga prerjet ilegale në pyjet publike arrijnë mbi 5.3 milionë euro për

<sup>37</sup> Aktgjykim, 514/19

<sup>38</sup> Raport vjetor për gjendjen e mjedisit 2022(AMMK)

katër vite dhe gjatë pesë viteve të fundit janë djegur mbi 10,000 hektarë, shkaktarë kryesor për këtë është njeriu, qoftë nga pakujdesia, padituria apo piromania si dhe temperaturat e larta.

Nga ajo që kemi cekur më lartë shihet se sa i përket mbrojtjes, zhvillimit dhe ripërtëritjes të hapësirave pyjore problemet kryesore janë: shfrytëzimi ilegal, mos ri kultivimi i hapësirave pyjore nga qiramarrësit, tjetërsimi i hapësirave pyjore shtetërore, mungesa e stafit të kualifikuar dhe mos menaxhimi i mirë i stafit teknik.

## Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit ne kemi parashtruar pyetjet e auditimit si në vijim:

1. Sa kanë arritur institucionet përgjegjëse të mbrojnë hapësirat pyjore?
  - 1.1 Sa arrin MBPZHR-ja të sigurohet në zbatimin e politikave të saj në fushën e pyjeve nga institucionet përgjegjëse?
  - 1.2 Sa kanë arritur APK-ja dhe AMMK-ja të sigurojnë mbrojtjen e pyjeve nga aktivitetet ilegale?
  - 1.3 Sa ka arritur APK-ja të ruaj pronat shtetërore nga uzurpimi dhe tjetërsimi?
2. Si janë menaxhuar aktivitetet dhe proceset për shfrytëzim të lëndëve drusore dhe hapësirave pyjore?
  - 2.1 Sa ka arritur APK-ja të bëjë realizimin e planeve për zhvillimin dhe ripërtëritjen e pyjeve?
  - 2.2 A është transparent procesi i qiradhënies së pronave shtetërore të menaxhuara nga Agjencia?
  - 2.3 Sa është arritur të ri kultivohen zonat pas përfundimit të projekteve?

## Kriteret e auditimit

Kriteret e auditimit për mënyrën e mbrojtës zhvillimit dhe ripërtëritjes së hapësirave pyjore janë të bazuara në ligjin për pyjet dhe ligjet tjera për mbrojtjen e parqeve kombëtare. Po ashtu janë përdorur planet strategjike të institucioneve përgjegjëse.

Zbatimi i politikave për pyjet në vend duhet të sigurohet nga departamenti i pylltarisë i cili ndër të tjera ka kompetenca: Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive në fushën e pylltarisë, bënë inventarizimin e përgjithshëm të pyjeve, kafshëve të egra, dhe organizimin, përpunimin, mbajtjen e statistikave pyjore, Mbikëqyrë implementimin e Ligjeve, akteve nënligjore dhe planeve menaxhuese të pylltarisë të cilat kanë të bëjnë me Pylltarinë dhe Mbikëqyrë Prerjet, Pyllëzimet e pyjeve të degraduara dhe tokave pyjore të zhveshura, erozive etj.<sup>39</sup>

MBPZHR përmes inspektoratit të pyjeve sigurohet në: mbikëqyrjen e gjitha aktiviteteve menaxhuese që kryhen në pyje, objektet e punës, mjetet dhe të gjitha vendet ku bëhet deponimi, përpunimi dhe qarkullimi i prodhimeve pyjore, mbikëqyrjen e realizimit të planeve menaxhuese, kontrollon dokumentacionin e damkosjes dhe origjinës së prodhimeve pyjore. Në rastet kur vërteton se është shkelur ligji apo rregullat të tjera, inspektori i pyjeve ndërmerr këto masa: ndalon prerjet e drunjëve të, bënë konfiskimin e përkohshëm të drunjëve të prerë në mënyrë të kundërligjshme, mjetet me të cilat janë kryer veprimet e tilla.<sup>40</sup>

Asnjë person nuk mund të presë dru në pyjet publike, përveç nëse personi ka licencën të vlefshme, dhe drunjtë, sipas ligjit në fuqi të jenë të shënuar para prerjes. Licenca për të prerë drunjtë në një pyll publik është vlefshme vetëm nëse prerja është në pëlqim me planin menaxhues operacional të vlefshme që mbulon atë pyll.<sup>41</sup>

<sup>39</sup> Rregullore (qrk) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ministrinë e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural (neni 18)

<sup>40</sup>Ligji nr.08/l-137 Për Pyjet

<sup>41</sup> Ligji Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, neni 20.



Sektorët për Shërbime Profesionale dhe Administrative në AMMK duhet të kujdeset ndaj resurseve natyrore të Parqeve Kombëtare dhe ndalimi i veprimeve ilegale, prerjet e pyjeve, gjuetinë, peshkimin, ndërtimin e objekteve, uzurpimin e pronave dhe identifikojnë personat që bëjnë vepra ilegale.<sup>42</sup>

Ministria miraton një plan të ri për secilin rajon të pyjeve publike së paku një herë në 10 vjet. Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.<sup>43</sup>

Agjencia duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare. Zyrtari Kryesor Administrativ kur ka dyshime për mashtrime, keqpërdorim, vjedhje apo humbje të pasurisë jo financiare duhet të merr vendime për inventarizimin e pjesshëm apo të tërësishëm kurdo që konstatohet një gjendje e tillë.<sup>44</sup>

Agjencia Pyjore duhet të kryejë inventarizimet e pyjeve publike dhe do të grumbullojë të dhëna të mjaftueshme mbi pyjet që të mundësojë planifikim racional menaxhues.

Agjencia Pyjore në bashkëpunim me njësit e veta duhet të miratojë planin vjetor operacional të menaxhimit për secilin grumbull pyjor të pyjeve publike nën administrim të saj, Planet e menaxhimit operacional përshkruajnë aktivitetet e përmirësimit të pyjeve dhe aktivitetet e prerjes. Agjencia Pyjore duhet të konsultohet me organet e interesuara komunale për miratimin e planeve të tilla. Agjencia Pyjore do t'i vërë planet e tilla në dispozicion për rishqyrtim prej publikut, përveç për dispozitat në plan, lëshimi i të cilave mund të vështirësojë zbatimin e ligjeve ose të rrezikojë resurset pyjore.<sup>45</sup>

Sektorët për Shërbime Profesionale dhe Administrative në AMMK duhet të hartojnë planet për menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve për mbrojtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore të Parkun Kombëtar "Sharr" dhe "Bjeshkët e Nemuna", po ashtu duhet të planifikojnë dhe zbaton masat për mbrojtjen dhe zhvillimin pyjeve.<sup>46</sup>

Procesi i dhënies së tokave bujqësore ku pronar/titullar është shteti duhet të jetë transparent dhe i hapur në mënyrë që të sigurojë llogaridhënien, mundësitë e barabarta për investitorët, po ashtu qeverisje të mirë dhe përdorim efikas të tokës.<sup>47</sup>

Dhënia e tokave pyjore në shfrytëzim bëhet në bazë të kriterëve të qarta, objektive, në pajtim me interesin publik dhe në bazë të vlerësimit profesional të Agjencisë, duke përjashtuar parimin "i pari në kohë, i pari në drejtësi".<sup>48</sup>

Krahas kërkesës për dhënien e lejes për ndërtime për shfrytëzim të përkohshëm të tokës bujqësore/pyjore për destinime të tjera si dhe për ndërtimin e përkohshëm nga e cila vjen deri te dëmtimi përreth i tokës bujqësore, shfrytëzuesi është i detyruar ta paraqet projektin për ri kultivim i cili bëhet në pajtim me dokumentacionin teknik për ndërtim.<sup>49</sup>

Nëse gjatë eksploatimit të lëndëve industriale dhe lëndëve tjera minerale nga toka bujqësore, çrregullohet regjimi ujor, apo vjen deri te përmytjet dhe grumbullimi i ujit, shfrytëzuesi është i detyruar që para kryerjes të ri kultivimit biologjik t'i kryej edhe punët hidroteknike me të

<sup>42</sup> Rregullore (qrk)-nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor (neni 57 dhe 60).

<sup>43</sup> Rregullore MF – nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 2..

<sup>44</sup> Rregullore MF – nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 18.

<sup>45</sup> Ligji nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, neni 18

<sup>46</sup> Rregullore (qrk)-nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor (neni 57 dhe 60).

<sup>47</sup> Kriteri i përcaktuar nga auditorët bazuar në gjykimin profesional

<sup>48</sup> Ligji nr.08/l-137 për pyjet, neni 14

<sup>49</sup> Ligji 02/L-26 për token bujqësore neni 17

cilat do të vendos regjimin e mëparshëm ujon në tokë. Nëse shfrytëzuesi pas përfundimit të eksploatimit të lëndëve industriale dhe mineraleve të tjera nuk e kryen ri kultivimin e tokës bujqësore, organi kompetent për bujqësi do të angazhoj organizatën tjetër e cila do të bëjë ri kultivimin e tokës me shpenzimet e shfrytëzuesit të tokës bujqësore për qëllime jo bujqësore.<sup>50</sup>

### **Fushëveprimi i auditimit**

Fushëveprimi i këtij auditimi është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht departamenti i Pylltarisë, i cili bënë hartimin e politikave në fushën e pylltarisë, ndërsa përmes Departamentit Qendror të inspektoratit për Pylltari dhe Gjueti, MBPZHR-ja do të sigurohet për zbatimin e ligjit për pyje.

Auditimi është fokusuar me theks të veçantë në aktivitetin e Agjencisë Pyjore të Kosovës, e cila vepron në kuadër të MBPZHR-së.

Fushëveprimi i këtij auditimi është edhe AMMK-ja, përkatësisht Drejtoria Parku kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" dhe Drejtoria Parku Kombëtar "Sharri".

Ndërsa në Agjencinë Kadastrale të Kosovës sigurojmë të dhënat kadastrale të pronave pyjore shtetërore me të gjithë emrat me të cilat ato janë të regjistruara. Po ashtu përmes mostrimit do të fokusojmë fushëveprimin tonë.

Për analizimin e proceseve të qiradhënies së hapësirave pyjore, nivelit të arritjes së planeve menaxhuese, periudha e auditimit ka përfshirë vitet 2020-2024, ndërsa për analizimin e ndryshimeve kadastrale përdorim të dhëna nga viti 2014.

### **Metodologjia e Auditimit**

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të auditimit, ekipi i auditimit kryen disa aktivitete në institucionet përgjegjëse duke përdorur një sërë teknikash audituese:

- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullative të MBPZHR-së për pyjet;
- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullative për pyje të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Intervistimin e personave përgjegjës dhe strukturat udhëheqëse të institucioneve përgjegjëse;
- Raportet e Agjencisë pyjore të Kosovës për pronat të cilat menaxhon;
- Planet për menaxhimin me Pyjet për vitet 2020-2024;
- Analizimi dhe krahasimi i certifikatave të pronave të cilat menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës dhe të Agjencisë Kadastrale të Kosovës nga viti 2014 deri (10.12.2024);
- Analizën e historikut të pronave aktuale të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe atyre të tjetërsuara;
- Intervista me zyrtarët e kadastrave në Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Analiza e planeve vjetore të punës dhe realizimit të tyre nga APK-ja dhe AMMK-ja;
- Thirrjet publike për ankandet apo tenderimet për shfrytëzim të produkteve pyjore nga Agjencia Pyjore e Kosovës;
- Procesverbalet e komisioneve lidhur me pronat e dhëna me qira;
- Listat e pronave të cilat kanë qenë në plan të ri kultivimit për periudhën 2015-2024.


### **Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant**

Pyjet shtetërore në Kosovë janë nën administrimin dhe menaxhimin e aktiviteteve përmes një hallke ndër-institucionale.

<sup>50</sup> Ligji 02/L-26 për token bujqësore neni 18

Ndërlidhjen e detyrave dhe përgjegjësiave mes institucioneve për menaxhim me pyjet shtetërore do ta paraqesim më poshtë:

Grafiku:3 Procesi i menaxhimit të pyjeve në vend nga MBPZHR dhe MMPHI.



Departamenti i Pylltarisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë ndër të tjera bënë:

- Propozimin, hartimin, nxjerrjen e politikave dhe strategjive zhvillimore për sektorin e pylltarisë;
- Zbatimin e legjislacionit dhe strategjive në fuqi, e që kanë të bëjnë me sektorin e pylltarisë;
- Propozon, harton dhe nxjerrë projekte të ndryshme për zhvillimin e sektorit të pylltarisë;
- Aprovon dhe nxjerrë vendime për dokumente, raporte, plane dhe projekte zhvillimore nga sektori i pylltarisë të hartuara nga organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare;
- Inventarizimin e përgjithshëm të pyjeve, inventarizimin e kafshëve të egra, inventarizimin e dëmtuesve pyjor, etj.
- Shqyrton, mbështet kërkesat e ndryshme për licencim dhe lëshon licenca për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme nga fusha e pylltarisë;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, akteve ligjore, strategjive dhe projekteve të ndryshme që ndërlidhen me fushën e pylltarisë;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të planeve të menaxhimit, planeve vjetore të pyjeve, gjuetisë, eko-turizmit, trajtimeve të pyjeve me masa të ndryshme silvikulturale<sup>51</sup> në prerje, tërheqje.
- Propozimin e masave për mbrojtjen e pyjeve, tokave pyjore, kafshëve dhe shpezëve biodiversitetit, peizazhit, etj.;

Departamenti Qendror të inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti ushtron funksionin e tij me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.

Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) si agjenci ekzekutive, kryen funksionet e saj duke u bazuar në politikat dhe planet e hartuara nga departamenti i pylltarisë në kuadër të MBPZHR-së.

Agjencia Pyjore ushtrimin e veprimtarisë së saj e bënë duke zbatuar planet strategjike për zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve, pastaj zhvillimin e tërë hapësirave pyjore e bënë përmes intervenimeve përmes aktiviteteve të prerjeve sanitare, pastrimit apo rrallimit përmes angazhimit të kompanive të specializuara për ato shërbime përmes prokurimit publik ndërsa planet për zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve private dhe shtetërore, rrjedhimisht prerjeve me plan i bënë përmes proceseve të ankandeve. Veprimtarinë e saj e ushtron përmes gjashtë njësive regjionale, të cilat ekzekutojnë planet e miratuara nga Agjencia dhe monitorojnë më nga afër hapësirat pyjore të regjioneve të caktuara.

AMMK-ja, në kuadër të të cilës veprojnë Drejtoria Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Drejtoria Parku Kombëtar “Sharri” menaxhon pyjet brenda parqeve kombëtare, përshtet funksioneve të tyre është paraqitur më poshtë:

Drejtoria për Administrimin e Parku Kombëtar “Sharri” dhe Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”:

- Kryen aktivitetet për planifikimin, ruajtjen, dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore;
- Kryen aktivitete kontrolli dhe parandalimi të veprimeve ilegale në park;
- Inicion fletëparaqitje për veprimet ilegale brenda territorit të Parkut Kombëtar;

<sup>51</sup> Ligji për Pyjet NR.08/L-137 Neni 3 Silvikultura përfshinë: trajtimin, pyllëzimin, ripërtëritjen dhe konvertimin e pyjeve

Pyjet në parqet kombëtare janë menaxhuar nga AMMK-ja deri në vitin 2023, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për pyjet Parqet Kombëtare menaxhohen nga dy institucionet, Agjencia Pyjore e Kosovës dhe AMMK-ja.<sup>52</sup>

<sup>52</sup> Ligji nr.08/l-137 për pyjet, neni 4. Plani i menaxhimit të pyjeve në Parkun Kombëtar hartohet nga Agjencia dhe miratohet nga Ministria, me pëlqimin e Ministrisë përgjegjëse për Mjedis. 5. Plani i menaxhimit të pyjeve në Parkun Kombëtar zbatohet përmes planeve vjetore dhe projekteve të hartuara në bazë të Ligjit për Pyje, Ligjeve për Parqet Kombëtare dhe Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, 2023.



## Shtojca 2: Letër konfirmimet

|                                                         |                              |                        |                              |
|---------------------------------------------------------|------------------------------|------------------------|------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  |                              |                        |                              |
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT                              |                              |                        |                              |
| NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE |                              |                        |                              |
| DATE PRANUAR DOKUMENTIN<br>DATE RECEIVED DOCUMENT       |                              |                        |                              |
| - 7-08-2023                                             |                              |                        |                              |
| Njësia Org.<br>Org. Unit                                | Shif. klasif.<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Br. Prot. | Nr. i faqeve<br>Br. Stranica |
| 06                                                      | 47                           | 1415                   | 1                            |



|                                                               |            |
|---------------------------------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO        |            |
| QEVERIA E KOSOVË Vlada Republike / GOVERNMENT OF KOSOVO       |            |
| MINISTRI I POLJOPRIVREDËS DHE PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL |            |
| MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT       |            |
| Kiv-e Dëshmive - Controling Archive - Control Archive         |            |
| Nr./Br.No.                                                    | 2525       |
| Nr. i fq./Br. Str./No. pg.                                    | 1          |
| Data/Datum/Date:                                              | 28.07.2023 |
| PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA                               |            |

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development Agency

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Mbrotjtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 28.07.2023

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Mbrotjtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore” (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Venera Çerkini

Sekretare e Përgjithshme MBPZHR





|                                                                 |                                             |                                     |                                         |
|-----------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO          |                                             |                                     |                                         |
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT                                      |                                             |                                     |                                         |
| NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE         |                                             |                                     |                                         |
| DITË E PRANUAR PËRZUAR:<br>DATE RECEIVED / SUBMITTED: 7-08-2025 |                                             |                                     |                                         |
| Nivello Org.<br>Org. Jedro.<br>Org. Unit                        | Shif. Klasif.<br>Klasif. Kod<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. | Nr. faqeve<br>Br. Stranica<br>No. Pages |
| 06                                                              | 47                                          | 1416                                | 1                                       |

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

  
Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agencija za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency

DE-341/2025  
30.07.2025

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit **“Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve, duke përfshirë komentet dhe plotësimet e adresuara përmes formularit për **“Komente nga institucioni i audituar në draft raportin e auditimit”**.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit  
Vendi dhe data:, Prishtinë 30.07.2025

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore”** (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Fidan DEMA  
U.D Drejtor Ekzekutiv

|                                                         |                              |                                     |                                           |
|---------------------------------------------------------|------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  |                              |                                     |                                           |
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT                              |                              |                                     |                                           |
| NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE |                              |                                     |                                           |
| DATE RECEIVED / SUBMITTED: - 7 - 08 2025                |                              |                                     |                                           |
| Njësia Org.<br>Org. Unit                                | Shif. Klasif.<br>Klasif. Kod | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. | Nr. i faqeve<br>Br. Stranica<br>No. Pages |
| 06                                                      | 47                           | 1417                                | 1                                         |



|                                                                      |          |
|----------------------------------------------------------------------|----------|
| REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO               |          |
| MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS     |          |
| MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE |          |
| MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE         |          |
| Organizata<br>Org. Instrukta<br>Org. Unit                            | AMMK     |
| Nr. i faqeve<br>Br. Stranica<br>No. Pages                            | 01       |
| Prillogje<br>Priloga<br>Attachment                                   | 5616/25  |
| Data<br>Datum<br>Date                                                | 23.07.25 |
| PRISTINE / A No 1                                                    |          |

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN  
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA  
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL  
PROTECTION AGENCY

Ref.60/AMMK/2025  
Me datë 23.07.2025

#### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit “Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit  
Vendi dhe data:, Prishtinë 23.07.2025

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore” (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet e raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Afrim Berisha


Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm



Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)

Adresa: Rruga “Luan Haradinaj”, ish pallati i mediave “Rilindja”, kati XV/04, 10000 Prishtinë  
Tel: 038 200 74 093, web: [www.ammk-rks.net](http://www.ammk-rks.net), Email: [ammk@rks-gov.net](mailto:ammk@rks-gov.net)





Zyra Kombëtare e Auditimit  
Lagjja Arbëria  
Rr. Ahmet Krasniqi, 210  
10000 Prishtina  
Republika e Kosovës